



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional “Shërbim Social”
Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Fan S. Noli” Korçë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Eglantina Dervishi

2. Dr. Anisa Subashi

Janar 2022

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT ME
KARAKTER PROFESIONAL “SHËRBIM SOCIAL”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan S. Noli” Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Sociale
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program Studimi me karakter profesional “Shërbim Social”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhri i hapjes nga MASR, Nr. 374, datë 05.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 72, date 09.04.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Program me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	11 PAE / 9 PAK
18	Numri i studentëve: 2020-2021 2021-2022	78 studentë 87 Studentë
19	Komente / të tjera:	-




PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Fan S. Noli" Korçë është një institucion publik i cili është hapur dhe liçensuar dhe ka filluar veprimtarinë e tij akademike në hapjen e disa degëve mësimore, mbi bazën e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.230, datë 29.05.1992 nën emërtimin "Universiteti Politeknik i Korçës"¹. Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.213 datë 24.05.1994 është miratuar riemërtimi i Universitetit Politeknik të Korçës në Universitetin "Fan S. Noli" Korçë². Ky Universitet aktualisht ka në përbërje të tij katër fakultete, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Bujqësisë, me pesëmbëdhjetë njësi bazë. Ky institucion ofron programe studimi profesionale, bachelor, master profesional, master shkencor dhe doktoratura. Me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.65, datë 21.09.2017 është bërë Akreditimi i parë Institucional i tij me kohëzgjatjen prej 5 (pesë) vitesh akademike³. Njësia bazë që ofron programin e studimit me karakter profesional "Shërbim Social" është Departamenti i Shkencave Sociale pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane. Programi i studimit me karakter profesional "Shërbim Social" është liçensuar me Urdhër të MASR. Nr. 374, datë 05.07.2018⁴. Programi i studimit me karakter profesional "Shërbim Social" i realizuar me 120 kredite (ECTS), në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohezgjatje normale 2 vite akademike, në gjuhën shqipe, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë profesionale në "Shërbim Social"⁵. Ky program studimi është organizuar sipas ndarjes ku përfshihen lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese të programit, lëndë ndërdisiplinore / integruese, si dhe lëndët plotësuese dhe detyrime përmbyllëse ku si pjesë e të cilit është provimi i përgjithshëm përfundimtar ose punimi i temës së diplomës. Numri i studentëve të rregjistruar në programin e studimit me karakter profesional "Shërbim Social" për vitin akademik 2021 – 2022, është gjithsej 40 studentë.

¹ Vendimi për hapjen e disa degëve në Universitetin Politeknik të Korçës

² Vendimi për dhënien e emrit "Fan Noli" Universitetit të Korçës

³ Vendimi për Akreditimin e parë të institucionit të arsimit të lartë Universiteti "Fan S. Noli" Korçë

⁴ Urdhër Për Hapjen në Universitetin "Fan S. Noli" Korçë, të programit të studimit me karakter profesional në "Shërbim Social"

⁵ Urdhër për rregjistrimin e formës së diplomës për programin e studimit me karakter profesional në "Shërbim Social" të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Qëllimi i këtij vlerësimi për programin e studimit 2 vjecarë me karakter profesional "Shërbim Social" është vlerësimi i shkallës së përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë, të cilat janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë". Vlerësimi i programit të studimit është një proces vlerësimi nga ekspertë të jashtëm i përcaktuar me urdhër të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë "Për përcaktimin e Ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit me karakter profesional, aplikuar nga Universiteti "Fan S. Noli" Korçë. Grupi i vlerësimit të jashtëm i përbërë nga Prof. Asoc. Dr. Eglantina Dervishi (drejtuese e grupit), Dr. Anisa Subashi (anëtare), Msc.Juna Mengri (koordinatore teknike) nisi punën për realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit të programit të studimit.

Raporti përfundimtar do të shërbejë jo vetëm për akreditimin e programit bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve, por gjithashtu informon Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, MASR, publikun e gjerë dhe studentët sesi programi i studimit me karakter profesional përmbush standardet. Përmes këtij raporti njësia kryesore dhe ajo bazë kanë mundësi të identifikojnë prioritetet në drejtim të rritjes dhe zhvillimit, duke e vënë theksin tek përmirësimi i cilësisë në drejtim të një procesi që zhvillon kompetencat profesionale të studentëve.

Standartet Shqiptare Shtetërore të Cilësisë janë të grupuara në pesë fusha kryesore vlerësimi bazuar tek Ofrimi, Organizimi dhe Drejtimi i Programit të Studimit me Karakter Profesional; Struktura dhe Përmbajtja e Programit të Studimit me Karakter Profesional; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet për Realizimin e Programit të Studimit dhe Mbështetja e Studentëve; Studentët dhe Mbështetja e tyre. Vlerësimi i secilës fushe bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve me 4 nivele: a - nuk përmbushen; b - përmbushen pjesërisht; c- përmbushen kryesisht; d - përmbushen plotësisht. Raporti në tërësinë e tij identifikon pikat e forta të programit të studimit bazuar në karakteristikat e praktikës së mirë, pikat e dobëta të cilat prekin çdo fushë, mundësitë që ka në dispozicion programi në drejtim të avancimit drejt cilësisë dhe pengesat, të cilat mund të vështirësojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara. Mbi bazën e këtyre indikatorëve grupi i vlerësimit të jashtëm ka dhënë edhe rekomandimet profesionale që do të shërbejnë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të programit të studimit me karakter profesional.

Më datë 28.12.2021, përmes sistemit AMS, Universiteti Fan S. Noli, Korçë është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm për këtë program studimi dhe me shkresë zyrtare Nr. Prot, 161/72, datë 28.12.2021.

Më datë 29.12.2021, Universiteti Fan S. Noli, Korçë përcjell në sistemin AMS shkresën me Nr. Prot, 880/3, datë 29.12.2021 me të cilën shpreh dakordësinë me përmbajtjen e draftit.

Sa më sipër, Draft- Raporti kthehet në Raport përfundimtar.

Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Shërbim Social”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit është hartuar në frymën e kuadrit të ri ligjor e në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” ⁶ ; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ⁷ dhe Vendimi nr. Datë 18.12.2019 ⁸ dhe në përputhje me politikat e brendëshme të institucionit e nevojave social-ekonomike të vendit. Programi i studimit me karakter profesional “Shërbim Social” është në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit “Fan S. Noli” Korçë ⁹ (UFNK) dhe janë të integruara në linjë me fushën e studimit brenda njësisë bazë të tij ¹⁰ .
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe të	Programi ofrohet në përputhje me statutin dhe rregulloren e tij, të cilat janë në linjë me drejtimet prioritare akademike të UK-ës. Duke iu referuar statutit të UK ¹¹ por edhe rregullores së njësisë bazë ¹² , asaj të programit të studimit me karakter

⁶ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 08-10-2021).

⁷ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 08-10-2021).

⁸ Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”


<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUuYWx8ZnNobnXneDo3NzYxM2UwZWVhMWEiYjdi> (Aksesuar më 08-10-2021).

⁹ Shtojca 1.1 Statuti i UK.

¹⁰ Shtojca 2.3. Rregullorja e Njësisë Bazë.

¹¹ Shtojca 1.1 Statuti i UK.

¹² Shtojca 2.3. Rregullorja e Njësisë Bazë.



<p>demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>profesional "Shërbim Social"¹³, ky program studimi është në linjë me vizionin dhe misionin e institucionit por edhe lidhur me respektimin e lirisë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe të studentëve, përmes një politike të brendëshme që synon ndërthurjen midis kompetencave profesionale të studentit dhe pajisjen me diplomë profesionale referuar nivelit të 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Gjithashtu duke iu referuar kushteve specifike përsa i përket zhvillimit të profesioneve, ky profil ka prespektivë të mirë të zhvillohet me tej dhe të kontribuojë në mënyrë efikase në avancimin e zgjidhjes së problemeve psiko-sociale e me të cilat ndeshet sistemi shërbimeve sociale në vendin tonë.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>Universiteti "Fan S. Noli" Korçë zotëron mekanizma të qartë në raport me funksionimin dhe organizimin e programit të studimit. Kjo është evidentuar edhe në Rregulloren e institucionit¹⁴, si dhe atë të programit të studimit¹⁵ që mbështetet në misionin dhe qëllimet e tij dhe në linjë me nevojat e tregut të punës. Programi i studimit me karakter profesional që mund të kryhet pas arsimit të mesëm, është hartuar nga Departamenti i Shkencave Sociale dhe konform nivelit të 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve¹⁶. Evidentohet se program i studimit është hartuar në frymën e kuadrit të ri ligjor dhe në përputhje me politikat e brendëshme të institucionit dhe nevojave social-ekonomike të vendit. Programi i studimit me karakter profesional është në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë dhe është integruar në linjë me fushën e studimit brenda njësisë bazë të tij. Gjithashtu duke iu referuar kushteve specifike përsa i përket zhvillimit të profesioneve të reja, ky profil ka prespektivë të mirë të zhvillohet me tej dhe të gjej terrenin e tij të punën në kontekstin shqiptarë por edhe jasht tij</p>
<p>Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun</p>	<p>Mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi, i cili paracakton si kriter studimin e tregut të punës para propozimit, hartimit dhe realizimit të një programi të ri studimi, nga njësia bazë. Përmes dokumenteve të vëna në dispozicion nga institucioni</p>

¹³ Shtojca 2.5. Rregullorja e Programit të studimit 2021-2022

¹⁴ Shtojca 1.2. Rregullorja e UK

¹⁵ Shtojca 2.5. Rregullorja e Programit të studimit 2021-2022

¹⁶ LIGJ Nr.10 247, datë 4.3.2010 PËR KORNIZËN SHQIPTARE TË KUALIFIKIMEVE.

https://financa.gov.al/ep-content/uploads/2018/06/LIGJ-10247-2010_korniza_shqiptare_e_kualifikimeve.pdf
(Aksesuar më 08.10.2021)

<p>lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>dhe më specifikiisht është bërë vlersimi i tregut të punës në periudhën tetor- nëntor 2017¹⁷ është realizuar një studim me qëllim identifikimin e nevojave për shërbim dhe asistencë sociale në popullatën e Bashkisë Korçë, si dhe njohejn e përmbushjes së këtyre nevojave nga institucionet shtetërore dhe private. Metodologjia e zgjedhur dhe procedura e ndjekur japin të dhëna të vlefshme për të kunkluduar mbi rezultatet e gjetjeve dhe për të dhënë rekomandime të dobishme lidhur me qëllimin e paracaktuar. Mbetet për tu vlersuar nisma e njësisë bazë për të ndërmarrë një studim që lehtëson procesin e grupit të punës i cili ka hartuar këtë program studimi. Një element pozitiv lidhet me kërkimin e kryer nga grupi i punës që ka hartuar programin profesional “Shërbim social” mbi ekperiencën e vendeve të zhvilluara, përsa i përket organizimit të lëndëve dhe moduleve. Megjithatë vlersimi i tregut të punës duhet të bëhet në mënyrë periodike me qëllim që t’i jap mundësi drejtuesve të programit të përmirësojnë cilësinë e tij, në përgjigje të nevojave të tregut të punës.</p>
<p>Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Ky program studimi me karakter profesional është hapur së fundmi dhe si rezultat e kemi të vështirë një analizë në vijimësi të ecurisë së studentëve përsa i përket përfshirjes së tyre në tregun e punës. Studime të mëtejshme pritet të ndërmerren nga institucioni përgjatë fillimit të brezit të tretë të studentëve, duke qenë se edhe situata e pandemisë ka pasur ndikimin e saj në monitorimin e vijimësisë së të diplomuarve pas përfundimit të studimeve. Megjithatë do të rezultonte me ndikim pozitiv lobimi nga ana e institucionit mbi vizibilitetin më të madh që mund t’i bëhet figurës së punonjësve të shërbimit social. Referuar edhe kushteve në të cilat ndodhet vendi ynë ku ka një vakum përsa i përket njohjes së profesionistëve të kualifikuar në “Shërbim Social” si një profil i veçantë në grupin e profesioneve me karakter human. Megjithatë institucioni duhet të ketë në mbështetje të punësimit të studentëve ngritjen e strukturës së bordit të punës si dhe pjesmarrjen në panairt e punës, të cilat duhen shfrytëzuar në mënyrë më efçente me qëllim që të lehtësojë futjen sa më shpejt në tregun e punës, të studentëve të programit me karakter profesional “Shërbim Social”.</p>
<p>Kriteri 6. Studimet paraprake dhe</p>	<p>Duke u mbështetur në dokumentacionin e vënë në</p>

¹⁷ Shtojca 3.12. Studimi I tregut të punës periodik në kuadër të hapjes së program studimi

<p>periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>dispozicion nga institucioni, kemi angazhim të grupit të ekspertëve që kanë realizuar studimin mbi nevojat e tregut të punës. Studimi ka synuar eksplorimin e nevojave të tregut mbi rolin e profesionistëve të shërbimit social kjo në rang lokal por edhe duke u bazuar në të dhënat nga programe studimi të ngjashme në univesitetet e tjera brenda dhe jashtë vendit. Angazhimi i grupit të punës në kontaktimin e një sërë strukturash shtetërore që operojnë në fushën e kujdesit psiko-social në qarkun e Korçës rezultojnë hapa që ndihmojnë institucionin për të pasur një panoramë reale të nevojave të tregut për profesionin e shërbimit social. Duke qenë se ky program ka pak vite që është hapur duhet parë sesi vetë UFNK do të arrijë të konsolidojë dhe integrojë këtë program në gamën e gjerë të profesioneve që mund të ushtrohen nga studentë të kualifikuar. Promovimi dhe lobimi për të, në struktura shtetërore dhe komunitet konsiderohen të domosdoshme për lexueshmërinë e diplomës në tregun e punës. Në këtë drejtim u evidentuan disa forma promovuese të ndërmarra nga institucioni si fletëpalosjet, ditët e hapura dhe promovimi në rrjetet sociale.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional “Shërbim Social” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale konform rregullave të paracaktuara nga ligjet në fuqi¹⁸ dhe kjo evidentohet në statutin¹⁹ e Universitetit “Fan S. Noli” Korçë rregulloren e njësisë kryesore²⁰, mbështetur në</p>

¹⁸ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri” https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 08-10-2021).

¹⁹ Shtojca 1.1 Statuti i UK.

²⁰ Shtojca 2.2. Rregullorja e njësisë kryesore

<p>detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>rregulloren e këtij programi studimi me karakter profesional²¹. Kordinimi i punës midis njësisë kryesore, asaj bazë dhe rolit të kordinatorit të programit të studimit “Shërbim social”²² krijojnë një infrastrukturë të përshtatshme për mbarëvajtjen e punës në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Duke u mbështetur edhe në vetë specifikat e ndërtimit të këtij programi studimi me karakter profesional, synimi është orientim i studentëve drejt tregut të punës në një kohë sa më të shkurtër dhe sipas një roli të mirë përcaktuar, roli i institucioneve bashkëpunuese është i rëndësishëm. Profili i asistentit në fushën e shërbimit social, është i nevojshëm në një sërë strukturash shtetërore apo private që ofrojnë shërbime ndaj kategorive vulnerabël. Në kuadër të zhvillimit të kompetencave profesionale të studentëve të këtij programi studimi me karakter profesional janë nënshkruar nga institucioni një sërë marrëveshesh bashkëpunimi²³ (në 12 marrëveshje bashkëpunimi me institucione private dhe publike, brenda qarkut) por në to nuk shprehet qartë mënyra sesi do të lehtësohet procesi i zhvillimit të kompetencave profesionale të studentëve, apo sesi nga këto marrëveshje do të kenë mundësi të përfitojnë studentët e këtij programi studimi në drejtim të njohjes së rolit të profesionistëve të fushës së shërbimit social²⁴ brenda institucioneve dhe në drejtim të punësimit të tyre, duke qenë se në organigramat e tyre nuk përfshihet profesioni i “Shërbimit Social”.</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për këtë program studimi ka hartuar një raport analitik që i përket vitit 2021²⁵, i cili duke iu referuar veprimtarive të realizuara në kuadrin e realizimit të praktikës profesionale është për tu vlersuar. Raporti paraqet një analizë të punës së saj në drejtim të përmirësimit të cilësisë në këtë program studimi në vijimësi përmes larmishmërisë në aktivitetet praktike që synon të ofroj për studentët e saj. Një element tjetër që vlen për tu evidentuar është edhe angazhimi i njësisë bazë për të vënë në zbatim</p>


²¹ Shtojca 2.5. Rregullorja e Programit të studimit 2021-2022

²² Shtojca 2.11. Vendimi i njësisë bazë për emërimin e kordinatorëve të programeve të studimit

²³ Shtojca 3.5. Tabela e institucioneve bashkëpunuese për praktikat

²⁴ Shtojca 3.6. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit

²⁵ Shtojca 3.6. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit





	<p>një sër pikash të këtyre marrëveshjes bashkëpunimi duke u fokusuar edhe në projektet dypalëshe, gjë e cila pritet të ketë një impakt pozitiv për të gjitha palët e përfshira, veçanërisht studentët e këtij program studimi me karakter profesional. Në vijim duke iu referuar institucioneve me të cilat kanë bashkëpunuar në drejtim të praktikës profesionale gjykojmë se ka një hapsirë për të njohur rolin e tyre të punës pothuajse në mënyrë të plotë, por duke mos pasur një specialist në fushë që është kualifikuar si asistent në “shërbime sociale” do të jetë e vështirë të kuptojnë rolin e tyre dhe të mos rrezikojnë të dublojnë një figurë tjetër profesionale si psikologun apo punonjësin social.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Grupi i vlersimit të jashtëm nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Universitetit “Fan S. Noli” Korçë dhe të konfirmuar në takimet e zhvilluara me drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë por edhe nga student, kemi praninë e një sër marrëveshjes institucionale²⁶ të lidhura me institucione publike dhe private lokale. Në bazë të këtyre evidencave gjykohet se kjo klimë ka impakt pozitiv dhe në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Marrëveshjet e bashkëpunimit institucional²⁷ që Universiteti “Fan S. Noli” Korçë ka nënshkruar për qëllime të zhvillimit të praktikës, shkëmbimit të eksperiencave dhe për realizimin e veprimtarive kërkimore shkencore²⁸ janë faktor kyç për zhvillimin e kompetencave didaktiko-praktike dhe të edukimit në vazhdim. Institucione si “Qendra Rezidenciale Korçë”, “Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor”, “Drejtoria e Shëndetit Publik”, “Bashkia Korçë” dhe “Bashkia Maliq”, “Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror”, “World Vision Korçë”, “Qendra për Zhvillimin e Fëmijëve” (KIDC) etj krijojnë mundësi shumë të mirë jo vetëm në drejtim të realizimit të praktikave profesionale por edhe në krijimin e hapsirave për të realizuar eksperiencat pune vulnetare apo punë sipas nevojave të institucioneve që kërkojnë shërbim social për moshën e tretë, grupmosha të ndryshme përfshirë fëmijët dhe të rriturit me nevoja të veçanta.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

²⁶ Shtojca 3.5. Tabela e institucioneve bashkëpunuese për praktikant

²⁷ Shtojca 2.10. Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale

²⁸ Shtojca 2.19. Mobilitete staf student ERASMUS+

Standardi I.3

Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit me karakter profesional “Shërbim Social” është hartuar në harmoni me legjislacionin vendas siç janë: Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ²⁹ dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ³⁰ dhe duke respektuar Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS) ³¹ . Kemi balancë në ndarje të lëndëve në lëndë të formimit bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/ integruese, plotësuese dhe detyrime përmblyëse sipas udhëzimeve të MASR ³² . Programi i studimit me karakter profesional pas arsimit të mesëm “Shërbim Social” realizohet me 120 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tij janë 2 vite akademik, i ndarë në katër semestra me peshën e fitimit të 30 krediteve për semestër ³³ . Në përfundim të programit të studimit me karakter profesional “Shërbim Social” lëshohet diploma profesionale në “Shërbim Social” në fushën e studimit “Shërbimit Social” për kategoritë me nevoja të veçanta ³⁴ .
Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfundimin e njohurive gjithëpërfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale	Ky program studimi i organizuar në 120 kredite (ECTS) me kohëzgjatje 2 vite akademike, i ndarë në katër semestra, është organizuar konform Vendimit Nr. 41, datë 24.1.2018. “Për Elementët e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Organizimi i lëndëve/moduleve janë hartuar në funksion të formimit të njohurive teorike dhe praktike në fushën e shërbimit social. Programi i kushton një vëmendje të veçantë nevojës së studentëve për njohuri të

²⁹Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 08-10-2021).

³⁰VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 08-10-2021).

³¹ Shtojca 2.7. Plani Mësimor i Programit të Studimit



³² Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave. Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”

<https://docs.google.com/a/fshn.edu.al/viewer?a=v&pid=sites&srcid=ZnNobi5lZHUuYWx8ZnNobnxneDo3NzYxM2UwZWZhMWE1Yjdi> (Aksesuar më 08-10-2021).

³³ Shtojca 2.8. Programet Lëndore të Programit të Studimit 2020-2021.

³⁴ Shtojca 2.6. Modeli i Diplomës Suplementit të Programit të Studimit

specialitetesh.	përgjithshme të lidhura me kulturën e punës së një profesionisti të shërbimit social. Por pesha e praktikës profesionale u jep mundësi studentëve të këtij program me karakter profesional zhvillimin e kompetencave të nevojshme profesionale për të mbuluar me sukses nevojat e rolit të tyre në fushën e shërbimit social.
Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.	Programi i studimit është ndërtuar me lëndë e module që ndihmojnë studentët të marrin njohuri të zgjeruar në drejtimin psikologjik, të punës sociale, e kujdesit shëndetësorë. Kjo ndërthurje midis këtyre profileve ndihmon zhvillimin e disa kompetencave profesionale që lehtësojnë ndërhyrjen praktike në kontekstin e punës së të diplomuarit. Mënyra e organizimit të programit të studimit me karakter profesional pas arsimit të mesëm i mundëson studentit një njohje më të thelluar dhe ndërdisiplinore të dijeve dhe njohurive teorike mbi proceset e rëndësishme të zhvillimit dhe funksionimit të individit në raport me grupin apo komunitetin ku jeton. Një element i rëndësishëm që plotëson më së miri dhe karakterin profesional të këtij programi është edhe ndërthurja e veprimtarisë praktike përgjatë dy viteve të studimit si pjesë e planit mësimor.
Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.	Ky program studimi profesional nxit tek studenti sensin e komunitetit dhe solidaritetin për të ndihmuar të tjerët në vështirësi. Nevoja për të qenë të trajnuar në mënyrë të përshtatshme në lidhje me asistimin e personave që u përkasin kategorive vulnerabel të cilët e kanë të pamundur të kryejnë vetëm aktivitetet e jetës së përditshme, është një kusht i domosdoshëm për këtë program studimi me karakter profesional. Kujdesi në këtë aspekt duhet të lidhet me përshtatjen e institucioneve ku realizohet praktika profesionale me nevojat e studentëve për të përfiturar përvojë të drejtpërdrejtë nga praktika në terren. Institucionet në strukturat e tyre duhet minimalisht të kenë një punonjës që ushtron detyrat e një punonjësi të shërbimit social, pavarësisht emërimit që mbart ky punonjës në strukturën e punës së institucionit. Do ishte e përshtatshme futja e studentëve jo vetëm nëpër shkolla e qendra fëmijësh, por kryesisht te institucionet që ofrojnë shërbime për moshat e treta dhe të gjithë ato individë me nevoja të veçanta që kanë nevojë për një profesionit që të ndihmojë në drejtim të përkujdesjes në përditshmërinë e tyre. Rreziku është që figurat e tjera me të cilat mund të atashohen studentët gjatë praktikës, siç mund të jetë psikologu, punonjësi social, mund të krijojnë konfuzion tek ato. Por duke iu referuar mungesës së përvojës në vendin

	<p>tonë për këtë profesion të ri, mund të justifikohet vështirësia e tyre në drejtim të realizimit të praktikës profesionale.</p> <p><i>GVJ del me këto rekomandime të përgjithsme për këtë kriter sugjerohet një angazhim i vazhdueshëm nga institucioni për të marrë në konsideratë aderimin e studentëve pranë qendrave të përkujdesjes rezidenciale për moshën e tretë, institucione private e publike që ofrojnë shërbime për individë me nevoja të veçanta në drejtim të përkujdesjes fizike.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>Universiteti “Fan S. Noli” Korçë dhe departamenti i Shkencave Sociale përmbush parametrat e kërkuar në drejtim të mënyrës sesi ka krijuar strukturën e nevojshme në funksion të realizimit të një procesi mësimor që i mundëson studentëve njohur të thelluar teoriko-praktike, mbi shërbimet e kujdesin social. Stafit i angazhuar në këtë proces ka kualifikimin e duhur profesional për të realizuar një proces të nxëni që ndihmon zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve. Bazuar në të dhënat e institucionit mbi stafin akademik³⁵ të përfshirë në mësimdhënie dhe duke iu referuar CV³⁶ të tyre mund të gjykojmë se ky kriter përmbush nevojat e programit për kapacitete dhe burime konform fushës akademike specifike. Bazuar në të dhënat që grupi i vlersimit të jashtëm ka shqyrtuar³⁷, rezultojnë se Departamenti i Shkencave Sociale për vitin akademik 2020-2021 ka gjithsej 29 pedagogë, nga të cilët 13 pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 1 ka titullin “Profesor Dr.”, 1 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 8 kanë gradën Dr., 1 docent. Msc dhe 1 Asistent Lektor me Msc dhe 15 pedagogë me kontratë (PAK). Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në këtë vit akademik, sipas evidencës³⁸ rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 20 pedagogë gjithsej, nga të cilët 1 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc, 8 me gradën Dr, 1 Dr. në proces, dhe 9 Msc. Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2020-2021 rezultojnë 11 pedagogë (72.09 %) PAE dhe 9 pedagogë (27.91%) PAK, mbështetur në ngarkesën e orëve në total në auditor për programin e studimit me karakter profesional.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë</p>	<p>Programi fokusohet në krijimin e profesionistëve të kualifikuar për të ofruar mbështetje në fushën e shërbimeve sociale. Shprehitë e reja profesionale do të ndihmojnë studentët e këtij programi studimi për të shfaqur kompetenca profesionale në drejtim të asistencës për individët apo grupet me nevoja të veçanta. Fokusimi i programit tek krijimi i</p>

³⁵ Shtojca 1.14. Udhëzimet për përmbajtjen e dosjes së stafit akademik.

³⁶ Shtojca 2.9. Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit.

³⁷ Verifikime stafi akademik nga ASCAL. Universiteti Fan S. Noli, Korçë, verifikim i stafit akademik date 20.05. 2021

³⁸ Tabela e Stafit Akademik- Diplomë Profesionale Shërbim Social

studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	shprehive bazë të komunikimit, marrja e informacionit të zgjeruar në drejtim të zhvillimit të individit, zhvillimit të aftësive në drejtim të identifikimit të nevojave dhe zgjidhjes së problemeve, të mësuarit sesi të japin ndihmën e parë në një urgjencë mjekësore të klientëve të tyre, janë të gjitha njohur të nevojshme që i pajisin studentët me kompetencat e duhura për të ushtruar profesionin e mbështetësit social. Gjithashtu drejtimi i secilës lëndë përmban një sërë veprimtarish didaktiko-praktike që realizohen si pjesë e seminareve duke lehtësuar në këtë mënyrë përvetësimin praktik të koncepteve teorike nga ana e studentit. Përvoja e praktikës profesionale është organizuar në mënyrë që t'u jap mundësi studentëve të përfitojnë kompetenca dhe njohuri praktike nga prekja e terrenit të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit me karakter profesional, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënimit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të	Programi i studimit me karakter profesional pas arsimit të mesëm "Shërbim Social" synon formimin e kompetencave dhe shprehive të nevojshme didaktiko-praktike që do t'i lejojnë studentët të orientohen lehtësisht drejt rolit të tyre profesional. Objektivat e tij janë të përcaktuar qartë në planin e tij mësimorë ³⁹ përmes lëndëve të lidhura drejtpërdrejt me zhvillimin e kompetencave teoriko-praktike që i përgjigjen nevojave të profilit profesional ⁴⁰ . Por edhe në

³⁹ Shtojca 2.7. Plani Mësimor i Programit të Studimit

⁴⁰ Shtojca 2.8. Programet Lëndore të Programit të Studimit 2020-2021.

<p>dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>	<p>rregulloren e programit të studimit përcaktohen qartë objektivat akademik që synojnë t'i japin këtij program studimi me karakter profesional pas arsimit të mesëm, dije dhe kompetenca në drejtim të shërbimit social. Kjo në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"⁴¹, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"⁴² si dhe nevojat e tregut të punës për profesionist të shërbimit social.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimore janë përgjithësisht konform ligjit për arsimin e lartë dhe urdhrave lidhur me respektimin e elementëve të veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite. Kemi një ndarje të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në kategoritë ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A e lëndëve Bazë që përmbajnë 10 % -15% (18 ECTS); - Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 45 % -55% (61 ECTS); - Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisciplinore / Integruese 5 % -15 % (18 ECTS); - Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 10 % -15% (17 ECTS); - Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse 3 % - 5 % (6 ECTS); <p>Ku kemi një ndarje të krediteve sipas tipit të komponentëve mësimorë nëpër kategori të shprehur në përqindje me 15% për kategorinë A; 50% kategoria B; 14% Kategoria D; 5% Kategoria E.</p> <p>Ky program studimi për secilën kategori, të përcaktuara sipas Vendimit Nr. 41, datë 24.01.2018)⁴³, respekton kufirin e numrit të krediteve bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Lidhur me ndarjen e ngarkesës sipas semestrave, ajo</p>

⁴¹ Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri"

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Akseuar më 08-10-2021).

⁴²VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Akseuar më 08-10-2021).

⁴³ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Akseuar më 08-10-2021).

	paraqitet konform ligjeve, me 60 kredite në secilin vit akademik, ku në çdo semestër student mund të grumbullojë 30 kredite.
Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.	Elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit të ofruar nga Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, siç janë plani mësimor ⁴⁴ dhe profili i programit por edhe përmbajtjen e programit të lëndëve ⁴⁵ për këtë program profesional studimin janë konform rregullave në fuqi (vendimi Nr. 41, datë 24.1.2018. “Për Elementët e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”). Mbështetur në disa element të rëndësishëm që kanë të bëjnë me përmbajtjen e tij gjykojmë se programi i pasqyron ato si pjesë të tij. Kemi një balancë midis mënyrës së paraqitjes së informacionit mbi ngarkesën mësimore, ndarjen sipas semestrave, orë në auditor dhe frekuentimin, vlerësimin e dijeve dhe një sër aktiviteteve specifike që synojnë të mbështesin aspektin praktik të përvetësimit të dijeve të akumuluar nga studentët.
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikën, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktiviteteve formuese të programit të studimit.	Syllabuset e programit ⁴⁶ me karakter profesional “Shërbim Social” janë konform modelit të përcaktuar nga MASR në shtojcën e vendimit Nr. 41, datë 24.1.2018. “Për Elementët e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Syllabuset e secilës lëndë janë të organizuara sipas strukturës së më poshtë me: përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit, objektivat dhe konceptet themelore, temat e lëndës dhe secila prej tyre përmbajnë një sërë veprimtarish praktike që realizohen si pjesë e seminareve duke lehtësuar në këtë mënyrë përvetësimin e koncepteve teorike nga ana e studentit. Silabusi i praktikës gjithashtu është organizuar në mënyrë që t’u jap mundësi studentëve të përfitojnë kompetenca dhe njohuri praktike nga prekja e terrenit të punës. Megjithatë mënyra sesi do të implementohet në kontekstin e mësidhënies do të varet nga vizioni dhe të kuptuarit e informacionit nga prespektiva e një profesionisti të shërbimit social.
Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje	Ky program studimi ka një koherencë në lidhje me elementët që synon të zhvillojë tek student në mënyrë që të lehtësojë realizimin e detyrave të kërkuar në tregun e punës për profesionin e “Shërbimit Social”. Duke qenë se programi synon të japë njohuri në lidhje me një sërë

⁴⁴ Shtojca 2.7. Plani Mësimor i Programit të Studimit

⁴⁵ Shtojca 2.8. Programet Lëndore të Programit të Studimit 2020-2021.

⁴⁶ Shtojca 2.8. Programet Lëndore të Programit të Studimit 2020-2021.

me punësimin.	<p>aspektesh të rëndësishme për zhvillimin e individit, problematikave që lidhen me shëndetin mendor dhe fizik, rëndësinë e kujdesit fizik dhe mbështetjes psiko-emocionale për kategori të ndryshme individësh që janë në kushtet e pamjatueshmërisë për të funksionuar në mënyrë të pavarur. Gjithashtu programi përfshin element mbi zhvillimin e disa shprehive profesionale që e ndihmojnë profesionistin e shërbimit social të realizojë detyrën e tij të përkujdesësit për këto target grupe individesh në mënyrë profesionale.</p>			
<p>Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>Aspekti praktik duket se preket përgjatë lëndëve të ndryshme teorike që studentët zhvillojnë në auditor dhe angazhimit në detyrat e kursit. Elementi më i rëndësishëm në mbështetje të këtij kriteri lidhet me hapsirën dhe shtrirjen e praktikës profesionale përgjatë të dyja viteve të studimit. Mbështetur në sa më sipër mund të konkludojmë se programi i studimit ka në dispozicion një strukturë që favorizon përvetësimin e njohurive praktike në drejtim të rritjes së kompetencave profesionale të studentëve që ndjekin këtë program studimi profesional. Mbetet për t'u parë nëse edhe implementimi i këtij programi u krijon kushtet e përshtatshme që studentët të prekin terrenin e punës në formën e duhur nën moniorimin e një profesionisti i cili kryen rolin e asistentit social. Vepritaritë praktike të përfshira si pjesë e leksioneve specifike duhet të fokusohen tek mënyra sesi zhvillohen shprehitë dhe kompetencat profesionale të lidhura me ndërhyrjen e sukseshme, referuar profilit të profesionistit të shërbimit social.</p> <p><i>Rekomandohet nga GVJ se elementi më i rëndësishëm në mbështetje të këtij programi me karakter profesional lidhet me hapsirën dhe shtrirjen e praktikës profesionale përgjatë të dyja viteve të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



Standardi II.2

Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e programit të studimit reflekton një koherencë me parashikimet e akteve ligjore referuar numrit të krediteve, 120 kredite, kohëzgjatjes normale të tij në 2 vite akademike, tipologjisë së lëndëve sipas veprimtarive formuese që karakterizojnë programin duke u mbështetur në VKM. Nr. 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” ⁴⁷ , vlerësimi në kredite e orë mësimore, si dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore në vite akademike dhe semestra. Planin mësimor ⁴⁸ është konform legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, me Statutin dhe Rregulloren e Universiteti “Fan S. Noli” Korçë
Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.	Bazuar në emërtimin e programit të studimit me karakter profesional ai është konform profilit dhe tipologjisë së profesionit të Shëbimit Social me një ndarje të ngarkesës mësimore sipas semestrave dhe viteve akademike. Lëndët kanë një shpërndarje në semestra që respekton kuadrin ligjor përse i përket vlerësimi në kredite për semester me nga 30 ECTS dhe të lëndëve mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të pritshme të të nxënit duke u krijuar mundësi studentëve të zhvillojnë të gjitha njohuritë që synojnë të përvetësojnë në këtë rrugëtim profesional. <i>Sugjerojmë të tregohet kujdes në drejtim të promovimit dhe lobimit në instancat e duhura në mënyrë që ky kualifikim profesional të njihet si profesion i rregulluar dhe të bëhet pjesë në organikën e një sër institucioneve shtetërore apo private që ofrojnë shërbime të kujdesit dhe asistencës për individët me nevoja të veçanta, veçanërisht për moshën e tretë.</i>
Kriteri 3. Planin mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve,	Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre referuar programit të studimit me karakter profesional pas arsimit

⁴⁷ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 08-10-2021).

⁴⁸ Shtojca 2.7. Planin Mësimor i Programit të Studimit

<p>syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>të mesëm “Shërbim Social” përfshin kryesisht lëndë të rezervuara metodologjisë dhe teorisë të asistencës dhe shërbimit social, si dhe një pikprerje me lëndë të sociologjisë, juridikut dhe punës sociale. Programet lëndore të profilit përfshijnë të gjithë elementët e paracaktuar në VKM 41. Kjo konsiderohet e rëndësishme për disiplinën e profilit të profesionit të shërbimit social, pasi profili profesional i tij, përgjatë rrugës së zhvillimit është mbështetur në këto disiplina për t’u zhvilluar. Arsyja pse kurrikulla e këtij programi profesional përfshin lëndë të tjera bazë nga profile të përafërta bëhet me qëllim që të balancohet njohuritë e mjaftueshme të studentit në lidhje me zhvillimin e dijeve, kompetencave në drejtim të studimit të individëve, grupeve dhe shoqërisë. Përsa i përket raportit teori/praktikë⁴⁹ përgjithësisht bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar por edhe gjatë vizitës në institucion u konfirmua gjatë takimit me drejtuesin e njësisë bazë e asaj kryesore por edhe me stafin, angazhimi në ruajtjen e raportit të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundjet atyre praktike (50 /50), ku për programin përkatës vlerësohet të jetë konform ligjeve në fuqi.</p>
<p>Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>Bazuar në përbushjen e këtij kriteri, nëse i referohemi planit mësimor⁵⁰ kemi një ndarje në linjë me VKM 41 midis veprimtarive formuese teorike (50%) të cilat zhvillohen në auditor dhe jashtë tij. Këto veprimtari kanë të ndërthurura aspektet teorike dhe praktike që të lejojnë aftësimin e studentit në përvetësimin e shprehive të nevojshme për të realizuar punën konkrete gjatë ushtrimit të profesionit të tyre (50%). Praktika profesionale e cila zë mbi 25%, hapsirë jo vetëm në lëndën e Praktikës Profesionale të shpërndarë në të dy vitet akademike. Ku vitin e parë studnetët angazhohen në një process pasiv praktike, bazuar në rolin e vëzhguesit dhe përgjatë vitit të dytë, praktika bëhet aktive, duke u krijuar hapsira për angazhim të drejtpërdrejt me klientin. Por edhe në lëndë të tjera mësimore mbulon nevojat e profilit për hapsira pune praktike, duke mbështet plotësisht nevojat e programit profesional për zhvillim kompetencash dhe aftësish të nevojshme për të gjetur veten lehtësisht në tregun e punës.</p>

⁴⁹ Shtojca 2.8. Programet Lëndore të Programit të Studimit 2020-2021.

⁵⁰ Shtojca 2.7. Plani Mësimor i Programit të Studimit

	<i>Sugjerimet tona si GVJ lidhen me nevojën për të përzgjedhur në mënyrë më të kujdesshme institucionet e praktikës, me qëllim që tu shërbejnë nevojave të studentëve të këtij profile për t'u përballur me marrësit e vërtetë dhe potencial të shërbimit të tyre.</i>			
Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Nëse i referohemi veprimtarive formuese dhe raportit midis formimit teorik dhe praktik, parimisht të lejon mundësinë për transferim kreditesh, mobilitetit, pasi janë konform udhëzimeve të MARS. Edhe pse ky program shihet si një indikator pozitiv përse i përket pritshmërive të institucionit për vizibilitet më të madh në tregun e punës, kjo mbetet për t'u parë nëse ky proces do të ketë ecuri normale dhe do të konsolidohet. Duke qenë se është program i hapur së fundmi duke parë mënyra sesi do t'i përthith tregu studentët e diplomuar ndër vite. Por gjithashtu edhe mënyra sesi vetë institucioni do të dijë të krijojë strategji efikase lobimi dhe promovimi të vetvetes dhe programit "Shërbim Social", i cili është i vetëm në llojin e tij, ofruar nga një Institucioni i Arsimit të Lartë në Korçë, duke u shërbyer nevojave të komunitetit.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënës dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.	Programi i studimit ka të dhëna të plota për modulet e lëndët që e përbërjnë, mwsimi nw auditor, leksione, seminare, praktika profesionale, kontroll i vazhdueshm i dijeve etj. Këto të dhëna repsektojnë elementët e kërkuar sipas VKM 41lidhur me kategorinë, tipin e komponentit mesimorë dhe numrin e krediteve për secilën kategori A, B, C, D dhe E si dhe orët e punës individuale të studentit. Lidhur me procedurat që ndjek institucioni në drejtim të realizimit të programit të studimit kemi një informacion të pasur me të dhëna që rregullojnë punën në drejtim të hartimit të syllabuseve të lëndëve sipas ligjeve shtetërore dhe sipas formatit të miratuar nga MASR, dhe i njëjti drejtim ndiqet

	edhe nga rregullorja mësimore e programit të studimit, e cila përcakton parimet e përgjithshme për këtë program studimi.
Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.	Ky program studimi i përgjigjet më së miri nevojave aktuale të vendit por edhe nevojave të tregut ndërkombëtarë përsa i përket profesionistëve që ofrojnë shërbime të asistencës në komunitet të ndryshme. Dinamika e jetës dhe individualizmi që bashkëshoqëron orientimin e shoqërisë drejt punës dhe angazhimeve të tjera kërkon profesionist të kualifikuar të cilët kanë kompetenca profesionale për t'u kujdesur për të moshuar, fëmijë me nevoja të veçanta, individë me vështirësi fizike, mendore etj. Ndërthurja e njohurive dhe shprehive profesionale që synohen të përvetësohen përmes këtij programi studimi profesional do t'i ndihmojë studentët të zotërojnë asetet e nevojshme të pritshme nga punëdhënësit e tyre.
Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.	Studentët të cilët përfundojnë këtë program studimi kanë mundësi që të fitojnë njohuri dhe kompetenca për të punuar në një sërë kontekstesh me persona të cilët kanë nevoja të veçanta. Modulet e këtij programi të lartë profesional të japin mundësi për marrjen e njohurive bazë për të punuar me tipologji të ndryshme individësh. Prezenca e një larmishmërie metodash që aplikohen në këtë program studimi të japin mundësi të mira në avancimin e studentit në drejtim të përvetësimit të njohurive të nevojshme. Format e vlerësimit të njohurive janë konform rregullave të brendëshme institucionale dhe ligjeve në fuqi për arsimin e lartë.
Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.	Mënyra sesi janë ndërtuar modulet e lëndëve të japin mundësi për fitimin e shprehive profesionale. Një sërë aktiviteish të formimit teorik dhe praktik të japin hapsirat e nevojshme për të përthyer në mënyrë të duhur aftësitë dhe shkathtësitë e nevojshme që i lejojnë profesionistit të shërbimit social të zhvillojë disa kompetenca profesionale si zgjidhja e problemeve, aftësi të mira komunikimi dhe ndërveprimi me njerëzit, të nevojshme për një vizibilitet më të madh në tregun e punës. <i>GVJ rekomandon njësinë bazë dhe stafin e angazhuar në këtë program studimi me karakter profesional të tregojë një vëmendje më e shtuar në përfshirjen e temave mësimore, të rasteve praktike lidhur me rolin e profesionit të shërbimit social, do të përmirësonte cilësinë në mësimnxënie dhe njohjen e këtij roli në një mënyrë më të konsoliduar nga ana e studentëve.</i>

Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.


Mbështetur në marrëveshjet e bashkëpunimit⁵¹, Universiteti “Fan S. Noli” Korçë ka lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi, prej të cilave 14 janë edhe për praktikat profesionale të studentëve të programit të studimit me karakter profesional. Më tej sipas të dhënave të vëna në dispozicion kemi organizimin e një sërë aktivitesh ekstrakurrikulare, ndër to, leksione të hapura me të ftuar të fushave të ndryshme. Në planin e përgjithshëm studentët e programit profesional “Shërbim Social” mund të përfitojnë nga këto aktivitete. Ajo që duhet të monitorohet me kujdes është, sa këto institucione kanë në organikogramën e tyre figura profesionale të specialistit të shërbimit social me qëllim që studenti realisht të fitoj praktikë dhe të mësoj nga një profesionist i fushës që ka mbaruar studimet dhe ushtron profesionin e Shërbimit Social, kjo me qëllim që të promovohet kjo figure e re profesionale në terrenet e ndryshme të punës.

Nga GVJ sugjerohet të ndërmerren nisma të tilla ku në qendër vendosin figurën e profesionit të Shërbimit Social, dhe jo të psikologut, psikoterapistit apo figurave të tjera profesionale. Kjo me qëllim që të lehtësohet kuptimi i rolit të punonjësit të shërbimit social, të njihen detyrat që ushtrohen prej tij në kontekstin e punës, sfidat e përditshme, dhe nevojat për trajnim të mëtejshëm.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

⁵¹ Shtojca 3.5. Tabela e institucioneve bashkëpunuese për praktikat



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>Institucioni ka në funksion të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie një sërë strukturash institucionale si Statuti⁵² dhe rregulloren e institucionit⁵³. Gjithashtu në mbështetje të programit të studimit me karakter profesional “Shërbim Social” është dhe rregullorja e programit të studimit⁵⁴ dhe përcaktimi i kordinatorit⁵⁵ të programit të studimit në një rol monitorues në vijimësi. Përveç këtyre strukturave, janë ngritur disa struktura të tjera që monitorojnë avancimin e programit të studimit konform rregullave dhe në linjë me vizionin e Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, siç është Njësia e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë⁵⁶ e cila është e përbërë nga 6 anëtarë të njësive kryesore të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë. Në drejtim të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë në mësimdhënie, kjo strukturë ndërmerr në mënyrë periodike aktivitete që kanë të bëjnë me administrimin e pyetësorëve për studentët⁵⁷ dhe për stafin akademik të angazhuar në mësimdhënie⁵⁸. Gjithashtu ajo bën përpunimin e këtyre rezultateve, dhe më pas bën shpërndarjen e informacionit në rang njësie kryesore dhe njësisë bazë.</p> <p><i>GVJ sugjeron që informacioni të shpërndahet tek studentët, duke organizuar një takim të hapur me student dhe pedagog për të diskutuar mbi ecurinë dhe problematikat që kanë nevojë të adresohen.</i></p>
<p>Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet,</p>	<p>Në nivel institucional janë ndërmarrë masat për përgatitjen e stafit përmes trajnimeve të ofruara me qëllim zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme të teknologjisë së informacionit lidhur me realizimin e procesit të</p>

⁵² Shtojca 1.1 Statuti i UK

⁵³ Shtojca 1.2. Rregullorja e UK

⁵⁴ Shtojca 2.5. Rregullorja e Programit të studimit 2021-2022

⁵⁵ Shtojca 2.11. Vendimi I njësisë bazë për emërimin e kordinatorëve të programeve të studimit

⁵⁶ Shtojca 1.5. Rregullore e drejtorisë së Kurrikulave (NJSBC, QKA)

⁵⁷ Shtojca 3.13. Pyetësori studentor

⁵⁸ Shtojca 3.14. Pyetësori I stafit akademik.

<p>seminaret, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>mësimdhënies diktuar edhe nga kushtet e pandemisë, ku mësimi është zhvilluar online⁵⁹. Aplikimi i metodave të ndryshme në lëndë e module mesimore, si studimet e rastit, analizat në grupe dhe individuale, detyrat e kursit dhe shkëmbimi i ideve, përdorimi i videove dhe artikujve ndihmojnë studentët të njihen me një mori formash interactive që lehtësojnë të kuptuarit e koncepteve teorike dhe përthyerjen e tyre në aspektin praktik e aplikative. Institucioni ka në funksion të përmirësimit të zhvillimit dhe përdorimit të metodave të ndryshme dhe innovative kjo e nxitur se fundmi edhe nga kushtet e pandemisë globale. Platforma elektronike “Microsoft teams” i mundëson stafit akademik dhe studentëve të shkëmbejnë materiale dhe informacione në funksion të procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Personeli akademik duket se ka kërkesa të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të lëndës/modulit me një literaturë të viteve të fundit, gjithashtu liria akademike në drejtim të organizimit të orëve mesimore sipas nevojave dhe nivelit të studentit i jep mundësi pedagogut të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktuara, përdorimi i teknologjisë si videoprojektori, diskutimi në grup, role play janë aktivitete që lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p><i>Mbështetur në vlersimin e planit mësimorë dhe syllabuseve të lëndëve GVJ rekomandon një angazhim më i madh i strukturave të institucionit në drejtim të pasurimit të fondit të bibliotekës dhe gjithashtu vet stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi me karakter profesional, për të përditësuar dhe pasuruar sillabuset e lëndëve me literaturë të viteve të fundit⁶⁰ për këtë profil profesional.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga institucioni, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi kanë kualifikimin e duhur dhe kompetencat e nevojshme për realizuar një proces të të nxënies i cili u mundëson studentëve të përfitojnë nga ndërthurja me një sërë formash interaktive në mësimdhënie. Nga vlersimi i mënyrave sesi janë hartuar sillabuset ka larmishmëri përsa i përket formave të përdorura në mësimdhënie, duke e vënë studentin në një pozicion aktiv gjatë orës së mësimt. Këto forma i përshtaten shumë mirë disiplinës së “Shërbimit Social” dhe ndihmojnë studentin të fitojë njohuri mbi fushën. Gjithashtu, nga studentët për pedagogët pati në përgjithësi komente pozitive mbi formën e realizimit të</p>

⁵⁹ Shtojca 2.18. Manual për mësimi online trajnime të stafit

⁶⁰ Shtojca 3.19. Model program i shkuartuar

	leksioneve dhe seminareve. <i>Gjithsesi rekomandohet nga GVJ një angazhim i stafit akademik në përmirësimin e literaturës bazë dhe asaj të rekomanduar që pjesërisht të jetë e 5 viteve të fundit, me qëllim ecjen me ritmet e zhvillimeve të fundit në fushën e shërbimit social.</i>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni në drejtim të inkurajimit të personelit akademik në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie përveç mundësive për pjesëmarrje pa pagesë të stafit akademik në konferencat e përbashkëta me institucionet e arsimit të lartë vendase dhe të huaja, lejon mobilitetin jashtë vendit nëpërmjet Erasmus + ⁶¹ , përfshirjen në projekte kërkimore, liria për të aplikuar në projekte kombëtare e ndërkombëtare. Një tjetër element me impakt pozitiv në mbështetje të stafit akademik është edhe mundësia e përfitimit të vitit sabbatik ⁶² . Këto aspekte shihen me ndikim pozitiv në drejtim të stimulimit dhe nxitjes së personelit akademik për avancim në karrierën e tyre profesionale dhe në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie. Duket se ka praktika të tilla që inkurajohen e mbështeten nga institucioni ⁶³ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Universiteti “Fan S. Noli” Korçë ushtron aktivitetin në 6 godina universitare. Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Humane ka vënë në dispozicion infrastrukturën fizike ⁶⁴ të nevojshme për realizimin e procesit mësimor ⁶⁵ , në një sipërfaqje prej 2400m ² . Njësia bazë ka në dispozicion të programit të studimit më karakter profesional “Shërbim Social”, 7 salla leksioni, me sipërfaqje 360m ² . Sallat e seminarit në dispozicion të procesit mësimor janë gjithsej

⁶¹ Shtojca 2.19. Mobilitete staf student Erasmus +

⁶² Shtojca 1.22. Rregullorja e përfitimit të sabbatik.

⁶³ Shtojca 4. Tabela përmbledhëse për programin e studimit

⁶⁴ Shtojca 1.15. Raporti i kontrollit të kapaciteteve të MASR

⁶⁵ Shtojca 4. Tabela përmbledhëse për programin e studimit

	<p>7 sallë me me sipërfaqje 185 m². Sallat janë të pastra dhe mirëmbahen nga stafi i agjencisë së kontraktuar për këtë shërbim. Gjithashtu institucioni disponon dhe i sallë për aktivitete promovuese, 11 laboratorë për lëndët me sipërfaqje 335 m², 2 një laborator informatike me sipërfaqje 75 m² i pajisur me infrastrukturën e nevojshme për një mjedis cilësor të mësimnxënies.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Ambjentet në mbështetje të procesit mësimor janë brenda standardeve dhe janë funksionale, janë të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimorë, si videoprojektor, kompjutera. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor 2 salla interneti me sipërfaqje prej 72 m², 2 salla bibliotekash me sipërfaqje prej 80 m².</p> <p>Institucioni ka në dispozicion të procesit të mësimdhënies dhe komunikimit në kohë reale me studentët për çështje të ndryshme platformat elektronike si Google classroom, Google meeting, Zoom apo Microsoft Teams. Për të mbështetur stafin dhe studentët në drejtim të kërkimit të literaturës edhe bibliotekën elektronike U-Library. Gjithashtu dy ambiente që janë në shërbim të stafit dhe studentëve në lidhje me avancimin e tyre në drejtim të hulumtimit të literaturës për aspekte të ndryshme që lidhen me procesin mësimor apo kulumtues shkencor, me infrastrukturën e nevojshme si kompjuter dhe internet. Bazuar më marrëveshjen e bashkëpunimit⁶⁶ midis institucionit dhe ofruesit të shërbimit për sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar për një sërë shërbimesh si për administrimin e të dhënave të studentëve, për procedurat akademike, provimet, sistemi i mënaxhimit të mësimdhënies, shërbimet e sekretarisë në formë elektronike⁶⁷.</p>
<p>Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë në gjuhën shqipe dhe të huaj⁶⁸, e cila është pasqyruar në dokumentacionin që GVJ ka shqyrtuar duket se ka nevojë të përditësohet me qëllim që t'i vijë në ndihmë këtij programi studimi. Një pjesë e literaturës është botim i një dekade⁶⁹, por prania e platformës për shërbim bibliotekar online si U-Library lehtëson dhe mbështet deri diku nevojat e stafit dhe të studentëve për literaturë. Përsa i përket literaturës në formë elektronike në gjuhë të huaj mund të thuhet se është bërë një përpjekje pozitive përmes abonimit në bibliotekën online.</p> <p><i>Për sa më sipër GVJ rekomandon: përditësimin e</i></p>

⁶⁶ Shtojca 1.6.1. Marrëveshja RASH për ESSE 3

⁶⁷ Shtojca 2.21. Udhëzuese ESSE 3

⁶⁸ Shtojca 2.23. Fondi i bibliotekës

⁶⁹ Shtojca 3.19. Model program i shkurtuar

	<p><i>literaturës me botime të 5 viteve të fundit; si dhe kujdes nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, në ruajtjen e një ekuilibri midis emërtimit të lëndës mësimore apo modulit dhe literaturës së përdorur për realizimin e saj.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Titujt fizik dhe elektronik që i referohen në total numrit të publikimeve fizike apo elektronik që janë në dispozicion për fushën e studimit “Shërbim Social” gjykohen pjesërisht të reduktuar. Kjo nënkupton tekste mësimore që i shërbejnë këtij programi profesional dhe mund të ndihmojnë stafin dhe studentët për të arritur objektivat e tyre mësimore dhe formative në drejtim të zhvillimit të kompetencave profesionale të këtij profesionisti të ri i cili akoma nuk njihet si profesion zyrtarisht nga shteti shqiptar. Megjithatë pedagogët dhe studentët shprehen se shpesh i kanë konsultuar burimet e literaturës online për nevojat e tyre akademike. Duke qenë se ky program është i karkaterit profesional, është e rëndësishme të merret në konsideratë fakti që target grupi i synuar për tu rregjistruar në të, nuk e kanë pikë të fortë gjuhën e huaj, dhe në këto kushte mbetet e vështirë të shfrytëzohen këto tituj në gjuhën e huaj nga studentët e këtij programi studimi.</p> <p>Nga ana tjetër nëse i referohemi dokumentacionit mbi pasurimin e departamentit me bazën material didaktike në funksion të procesit mësimor përmban një liste me tekste, ku një pjesë e tyre janë me botime më të hershme dhe që paraqesin probleme serioze në mënyrën e përkthimit në gjuhën shqipe, ku terminologjia e fushës është tjetërsuar duke e bërë të vështirë të kupuarit e tekstit.</p> <p><i>Sugjerimi i GVJ në lidhje me tekstet lidhet me vlersimin drejtë të atyre teksteve që realisht u shërbejnë studentëve të këtij programi studimi dhe që plotësojnë disa parametra në drejtim të cilësisë dhe standateve të kërkimit shkencor në mënyrë që të përdoren si tekste bazë në mësimdhënie, e që lidhen me fushën e ngushtë të studimit “Shërbim Social”.</i></p>
<p>Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët kanë në dispozicion të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies platformën elektronike të aksesimit në bibliotekën online të U-Library (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online), 2 qendra interneti dhe dy salla bibliotekash të cilat aksesohen nga të gjithë sipas orarit të ofrimit të shërbimit. Gjithashtu mund të thuhet se fondi i bibliotekës së institucionit kishte tekste në formë</p>

	<p>elektronike të fushës sociale në gjuhë të huaj që viheshin në dispozicion të stafit dhe studentëve të programit të studimit. Abonimi në revista profesionale specifike ndoshta do të ndihmonte stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie në këtë program profesional, të vihen në kontakt me avancimet më të fundit në këtë fushë dhe problemet me të cilat përballen profesionistët sot në botë, por edhe për të qartësuar konceptin mbi rolin e profesionistit të shërbimit social.</p> <p>Shqetësim mbetet fakti sesi mund ta shfrytëzojnë këtë mundësi studentët e këtij programi studimi duke qenë se tekste janë në gjuhë të huaj.</p>			
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në kushtet e pandemisë ky kriter u kthye në domosdoshmëri dhe në këtë drejtim institucioni përdor një sër platformash elektronike në funksion të mësimdhënies. Si infrastrukturë teknologjike në funksion të mësimdhënies është platforme on-line Microsoft Teams, Google Classroom etj (e-learning) që lejon studentët dhe stafin akademik të mund të komunikojnë dhe ndërveprojnë për qëllime të procesit të të nxënies. Në këtë drejtim infrastruktura që disponohet ka të bëjë me salla informatike e pajisur me kompjutera, biblioteka me platformën elektronike U-Library dhe salla interneti. Platforma on-line presupozohet u japin mundësi studentëve të kenë akses në dokumenta dhe materiale didaktike të pedagogëve të lëndëve të ndryshme on-line, apo marrja e shërbimeve on-line si rregjistrimi për provime, marrja e vlersimeve duke përdorur sistemin elektronik etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi III.3

Institucioni ngrre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional</p>	<p>Institucioni ka ngritur disa struktura, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm</p>



që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.

në mësimdhënie. Përmes Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor⁷⁰, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit⁷¹, Grupi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë⁷². Puna e këtyre strukturave synon monitormin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie duke përshtatur kurrikulën e programeve të studimit me standartet shtetërore dhe ato ndërkombëtare. Strukturat përgjegjëse për monitorimin e sigurimit të cilësisë⁷³ dhe respektimin e standarteve të reja për rritjen e cilësisë në mësimdhënie, ka ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim. Së pari përmes raportit vjetor të njësisë bazë⁷⁴, raportit të përfuturit nga marrëveshjet e bashkëpunimit për praktikën profesionale në funksion të programit të studimit me karakter profesional "Shërbim Social" si dhe të analizës në përfundim të çdo moduli përmes vlersimit të studentëve⁷⁵. Këto nisma lejojnë të mblidhet një informacion i detajuar mbi një sër aspektesh si vështrimi i përgjithshëm i gjendjes së programit të studimit, praktikën profesionale, plani i veprimit për vitin e ardhshëm, raportimi mbi veprimtaritë e ndërmarra, feedback-u i marrë nga studentët dhe stafi akademik në nivel programi, statistika të regjistrimit të studentëve dhe të kalueshmërisë së tyre, burimet mbështetëse të programit të studimit, vlersimi i jashtëm, karriera dhe alumnit, profesionet e rregulluara si dhe praktikat e mira nga institucionet e tjera. Vlerësim që kryhet nga grupi i sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel departamenti monitoron programin në vijimësi, duke u siguruar informacione të rëndësishme si Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional ashtu edhe njësisë kryesore dhe asaj bazë⁷⁶. Së dyti institucioni përmes Sektorit të Kurrikulave, Vlersimit Institucional dhe Alumni në kuadër të monitorimit të mbarëvajtjes së procesit mësimorë në platformat elektronike, ka mbledhur informacion të rëndësishëm për njohjen e situatës nga administrimi i pyetësorëve për studentët⁷⁷ dhe stafin akademik⁷⁸ të angaxhuar në mësimdhënie. Prania e këtyre elementëve konsiderohen me ndikim pozitive në drejtim të mbajtjes së lidhjeve të vazhdueshme me studentët.

⁷⁰ Shtojca 1.5. Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave (NJSBC. QKA)

⁷¹ Shtojca 1.4. Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit

⁷² Shtojca 3.3. Vendimi I Njësisë Bazë për Ngritjen e GVB

⁷³ Shtojca 3.7. Raporti Vjetorë Të NJSBC 2019-2020

⁷⁴ Shtojca 3.8. Analiza Vjetore e Veprimtarisë së Njësisë Bazë

⁷⁵ Shtojca 3.17. Model analize në përfundim të një moduli.

⁷⁶ Shtojca 3.8. Analiza Vjetore e Veprimtarisë së Njësisë Bazë.

⁷⁷ Shtojca 3.13. Pyetësori studentor

⁷⁸ Shtojca 3.14. Pyetësori I stafit akademik.

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Njësia kryesore dhe ajo bazë në bashkëpunim me zyrën e sigurimit të cilësisë ka ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim. Mjetet si raportit vjetor i programit të studimit i cili lejon të mbledhet një informacion i detajuar mbi një sërë aspektesh të rëndësishme⁷⁹. Si dhe grupi i sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel departamenti⁸⁰ i cili monitoron programin në vijimësi, duhe u siguruar informacione të rëndësishme si zyrës së sigurimit të cilësisë në nivel institucional ashtu edhe njësisë kryesore dhe asaj bazë.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	<p>Personeli i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin e duhur, zotërojnë fushën e ekspertizës dhe janë në përputhje me lëndët apo modulet që mbulojnë në këtë program studimi me karakter profesional. Në lidhje me kualifikimin e stafit akademik, përsa i përket përmirësimit të aftësive në mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja mund të përmendim trajnimet, konferencat e projektet e përbashkëta të ndërmarrë ng njësia bazë, në të cilën janë pjesmarrës stafi akademik dhe studentët⁸¹. Përfshirja në një sër projektesh dypalëshë të safit dhe studentëve të njësisë bazë, mobiliteti përmes programeve Erasmus +⁸², ndihmojnë procesin e të nxënit dhe lehtësojnë përvetësimin e materialit teorik më lehtësisht nga studentët e këtij programi profesional⁸³. <i>Sugjerohet nga GVJ të tregohet kujdes në përshtatjen e pjesës praktike me nevojat e këtij profili profesional.</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit e tyre.</p>	<p>Strukturat dhe njësia bazë duket se inkurajojnë format e reja dhe inovative në mësimdhënie përmes hapësirave në drejtim të organizimit të leksioneve të hapura me lektorë të ftuar vendas dhe të huaj, konferenca shkencore, simpoziume, ëorkshop-e, mbështetje në publikimin e monografive, artikuj shkencor dhe projekte të përbashkëta e trajnim⁸⁴. Institucioni duket se bën përpjekje në këtë drejtim përmes kërkesës për përditësim të literaturës për lëndët përkatëse dhe avancimit në drejtim të kërkimit shkencor⁸⁵ përmes krijimit të mundësisë për publikime dhe shfrytëzimit të bibliotekës online U-Library.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë</p>	<p>Në lidhje më këtë kriter nuk kemi evidenca të qarta përsa i përket testimin dhe analizës nga ana e stafit mbi metodat</p>

⁷⁹ Shtojca 3.8. Analiza Vjetore e Veprimtarisë së Njësisë Bazë

⁸⁰ Shtojca 3.3. Vendimi I Njësisë Bazë për Ngritjen e GVB

⁸¹ Shtojca 3.8. Analiza Vjetore e Veprimtarisë së Njësisë Bazë

⁸² Shtojca 2.19. Mobiliteti staf student ERASMUS +

⁸³ Shtojca 3.6. Raporti i përfitimit nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit.

⁸⁴ Shtojca 2.20. Analiza e veprimtarisë së UK.

⁸⁵ Shtojca 3.8. Analiza Vjetore e Veprimtarisë së Njësisë Bazë

<p>metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>e reja në mësimdhënie. Por vërtetohet se ka procedura që ndiqen nga institucioni mbi monitorimin e procesit të mësimdhënies përmes formatit të vlerësimit të pedagogut nga studenti, dhe formulari i vlerësimit të performances nga stafi akademik, procedura që synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar në mësimdhënie. Në mënyrë indirekte angazhimi në projekte e veprimtari të tjera ekstrakurrikulare krijon një klimë të favorshme për përmirësimin e kompetencave profesionale të stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi me karakter profesional pas arsimit të mesëm por edhe rritjes së gamës së njohurive didaktiko-praktike të cilat shpalosen në një zotërim më të mirë të lëndës që mbulon e në trasmetimin e dijeve në mënyrë korrekt e të qarta për studentët.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.4



Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimmimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloren mësimore të programit të studimit⁸⁶, sistemin e vlersimit të studentit, formatin e tezës së provimit përfundimtar, Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive⁸⁷, udhëzimet për mënyrën e realizimit të detyrave të kursit⁸⁸ bëhen publike dhe njihen nga studentët përmes sekretarisë mësimore dhe vetë pedagogut të lëndës në fillim të çdo semestri. Kjo procedurë respektohet nga stafi akademik dhe studentët informohen në lidhje me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në silabuset e lëndëve/moduleve, në orët e para, si dhe ky informacion i</p>

⁸⁶ Shtojca 2.5. Rregullorja e Programit të studimit 2021-2022

⁸⁷ Shtojca 2.15. Pyetjet e provimit të formimit

⁸⁸ Shtojca 2.25. Model i punës së kursit në lëndë specifike

<p>Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>jepet studentit në departamentin e shkencave sociale.</p> <p>Studentit i jepen hapësirat e nevojshme për të demonstruar përvetësimin e njohurive përmes vlersimit nga detyrat e kursit, mendimet dhe reflektimet personale të shpalosura në auditor, formës së hartimit të testit të ndërmjetëm dhe final⁸⁹ me diversitet pyetjesh dhe formash të nxitjes së të nxënit. Duke i dhënë në këtë mënyrë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara në varësi të stilit personal të të nxënit. Të gjitha procedurat e lidhura me testimin, vlerësimine njohurive janë të pasqyruara në rregulloren e programit të studimit⁹⁰ dhe në lëndët mësimore të programit të studimit me karakter profesional⁹¹.</p>
<p>Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>Bazuar në hartimin e lëndëve/moduleve të programit të studimit me karakter profesional në fillim të çdo semestri nga titullari i lëndës bëhet njohja me të gjitha aspektet që përfshijnë studentët si frekuentimi, metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve, detyrat e kursit, riprovimet etj. Pedagogu jep një informacion të shtjelluar edhe në fund të semestrit para vlersimit të njohurive bazuar në informacionin që na u komunikua nga studentët gjatë vizitës në institucion.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimatën, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë: nxitjen e studentit që të mësojë gjatë gjithë vitit, realizimi i një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim dhe në funksion të vlerësimit të ecurisë së kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. Aplikimi i kësaj praktike për testim dhe vlerësim shihet si pozitive në drejtim të një objektiviteti në vlersimin e performancës akademike të studentit. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim ose me gojë. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar për programin e studimit. Nuk kemi</p>

⁸⁹ Shtojca 2.15. Pyetjet e provimit të formimit

⁹⁰ Shtojca 2.5 Rregulloja e programit të studimit 2021-2022

⁹¹ Shtojca 2.8. Programet lëndore të programit të studimit 2020-2021




	evidence për realizimin e testimit përmes sistemit elektronik.			
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Njësia bazë ka një strukturë të mirë organizuar në drejtim të hapave e procedurave që ndjek në drejtim të miratimit, dhe kohës së përgatitjes së tezës së provimit nga pedagogu i lëndës. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për zhvillimin e provimit, por ai shoqërohet nga një anëtar i stafit akademik, bazuar në vendimin e komisionit të provimeve sezonale. Praktikant profesionale, provimi i përgjithshëm përfundimtar, realizohen me komision prej dy ose më shumë anëtarësh. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim nga ana e sekretarisë mësimore, që bën sekretimin e tezave. Me përjashtim të pedagogut të lëndës, të monitoruesve të ngarkuar nga drejtuesi i departamentit, në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë. Tezat janë të sekretuara dhe provimi realizohet duke ruajtur anonimat e çdo studenti. Ç'sekretimi i tezave të korrigjuara të provimit dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, e cila bën ç'sekretimin e tyre dhe nxjerrjen e rezultatit për secilin student.			
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.	Institucioni disponon një strukturë të mirëfilltë përsa i përket gjithë procesit që lidhet me procedurat e provimit, vlerësimit, shpalljes së rezultateve dhe ankimit nga ana e studentit. Procedura që zbatohet nga institucioni përfshin rregullat sipas përcaktimeve përkatëse sesi bëhet kontrolli i vazhdueshëm i dijeve, hyrjen në provim dhe gjithçka tjetër që i përket këtij procesi. Institucioni respekton procedurat e njohjes me vlerësimin, kushtet dhe hapat për rishikimin e vlerësimit. Këto procedura janë konform legjislacionit në fuqi dhe rregullores së programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përftimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxëniet për programet me karakter profesional.	Programi i studimit me karakter profesionali u jep mundësi studentëve të zgjerojnë njohuritë në një gamë të gjerë profilesh në kontekstin e punës sociale, ligjore, psikologjisë, sociologjisë dhe pjesërisht të mjekësisë me fokus në dhënien e ndihmës së shpejtë dhe të ndërhyrjes në një emergjencë mjekësore. Duket se kjo larmishmëri mund të shihet si pozitive në drejtim të thellimit të njohurive për aspektet më të imta që lidhen me fushën dhe në një aftësi për të zhvilluar kompetenca profesionale te studentët përsa i përket profilit të “Shërbim Social”.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.	Njësia bazë dhe ky program studimi krijojnë të gjitha kushtet që studenti të zhvillojë aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit si në aspektin teorik përmes lëndëve që janë pjesë e kurrikulës për këtë program studimi, por edhe praktikisht përmes hapsirave që u jepen studentëve për të përdorur sistemin online të shfrytëzimit të literaturës në bibliotekat online. Në drejtim të komunikimit dhe ndërveprimit kemi një sërë aktivitetesh që ndikojnë pozitivisht në këtë drejtim si angazhimi i stafit bashkë me studentët në veprimtari dhe aktivitetet ekstra kurrikulare ⁹² ku janë përfshirë studentët, si veprimtari bamirësie, konferenca dhe leksione të hapura, që u japin mundësi ndërveprimit dhe përvetësimi të njohurive të reja mbi fushën.
Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet	Ky kriter bazuar në mënyrën e ndërtimit të silabuseve të lëndëve/moduleve por edhe bazuar në takimet e realizuara me stafin akademik dhe studentët, duket se përmbushet plotësisht. Pasi mësimdhënia bazohet në diskutimet e ndryshme, nxitjen e mendimin kritik mbi çështjet që trajtohen duke e vendosur studentit në një pozicion aktiv në drejtim të përvetësimi të dijeve dhe të nxëniet në tërësi. Përsa i përket mundësisë për zhvillimin e mësimdhënies mbi bazë kompetencash ka evidenca që na ndihmojnë të gjykojmë mbi këtë aspekt. Ky program me karakter profesional i jep një rëndësi të veçantë përvojës së praktikës

⁹² Shtojca 2.14. Veprimtari studentore


<p>bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>profesionale, si një aset i domosdoshëm për zhvillimin e kompetencave të studentëve. Por edhe disa module të lëndëve karakterizuese jo vetëm kërkojnë njohuri të thelluara teorike të marra përmes kualifikimit akademik, por gjithashtu njohuri dhe kompetenca praktike që duhen zhvilluar përmes përvojës praktike të fituar drejtpërdrejtë në fushë. Në drejtim të mobilitetit të studentëve të këtij programi studimi nuk kemi evidence që të jetë realizuar.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Ky element duhet parë në vijimësi, pasi ky program studimi është kryesisht i ri, mënyra sesi do impletojë në planin mësimorë të lëndës idetë inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore në mbështetje të nevojave të studentit në lidhje me avancimin në njohuri mbetet një sfidë. Kjo duke iu referuar përvojës së pakët në drejtim të avancimit të politikave sociale në lidhje me rolin e “Shërbim Social” në vendin tonë dhe mungesën e përvojës së institucioneve të tjera të arsimit të lartë, të një programi të tillë studimi. Raporti i vlersimit të pedagogut në përfundim të lëndës mbi ecurinë e saj dhe arritjen e objektivave formative në raport me mësimnxënien është pjesë e procedurave që ndiqen nga institucioni.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e pullike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Bazuar në rregulloren mësimore të programit të studimit me karakter profesional⁹³. Programi përfundimtar i provimit të studimeve të larta “Shërbim Social” e provimit të përgjithshëm përfundimtar, institucioni ka hartuar një udhëzues për përgatitjen e studentëve, të cilët do të japin provimin final⁹⁴. Mbështetur në procedurat e njësisë bazë mbi administrimin e provimit final komisioni i ngritur për këtë qëllim ndjek parimin e respektimit të kriterit ku për secilën kategori mund të ofrohen një numër i ndryshëm pyetjesh, për lëndë të kategorisë A, lëndë të kategorisë B, grupi i lëndëve të kategorisë. Përgjithësisht respektohet balanca në testimin e njohurive të dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Institucioni për ruajtjen dhe arkivizimin e informacionit dhe paisjen e studentit me informacionin e nevojshëm ndjek rregullat që i dikton legjislacioni dhe rregullorja për ruajtjen e të dhënave⁹⁵ dhe sekretarisë mësimore⁹⁶. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Nga takimi me aktorët përkatës mësohet se institucioni disponon një databazë</p>

⁹³ Shtojca 2.5. Rregullorja e Programit të studimit 2021-2022

⁹⁴ Shtojca 2.15. Pyetjet e Provimit të formimit

⁹⁵ Shtojca 1.9. Rregullore Ruajtjes së të Dhënave

⁹⁶ Shtojca 1.10. Rregullorja e Sekretarisë Mësimore

	të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit.			
Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.	Në drejtim të krijimit të mundësive për realizimin e veprimtarive praktike për studentët e këtij programi studimi jashtë institucionit, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë ka nënshkruar një sër marrëveshesh bashkëpunimi. Duke qenë një program studimi me karakter profesional, diplomimi i studentëve realizohet me temë diplome ose përmes provimit të përgjithshëm përfundimtarë, i cili hartohet nga komisioni i provimit. Studentët pajisen me një udhëzues për provimin e përgjithshëm përfundimtarë ⁹⁷ nga departamenti me qëllim përgatitjen e tyre për t'u përballur me sukses me këtë proces. Stafi akademik i këtij programi studimi ka rol mbështetës dhe orientues në drejtim të përgatitjes së studentëve që do punojnë për mbrojtjen e diplomës temë, duke qenë të hapur të ndihmojnë studentët nëse kanë pyetje apo paqartësi në lidhje me realizimin e punimit final, gjithashtu duke monitoruar respektimin e kritereve të përcaktuar në lidhje me strukturën e punimit të diplomës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

⁹⁷ Shtojca 2.15. Pyetjet e Provimit të formimit

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Institucioni ka procedura për rekrutimin e personelit akademik të cilat janë të reflektuara në statutin⁹⁸ dhe rregulloren e institucionit⁹⁹, të cilat janë në harmoni me ligjin në fuqi. Departamenti në bazë të nevojave bën planifikimin për staf akademik, kjo e bazuar dhe në numrin e studentëve bën propozimin dhe përcakton kriteret sipas ligjit në fuqi përsa i përket rekrutimit. Proçedurat e rekrutimit që ndjek Universiteti “Fan S. Noli” Korçë hartohen në përputhje me legjislacionin në fuqi. Zyra e Burimeve Njerëzore¹⁰⁰ bashkëpunon me Njësinë bazë për shpalljen e thirrjes në Buletinin e Prokurimeve Publike. Gjithashtu ngrihet dhe një komision ad-hoc i përbërë nga pedagogë dhe punonjës shkencorë efektive¹⁰¹. Miratimi i stafit akademik bëhet në fillim të çdo viti akademik në varësi të nevojave të njësisë bazë dhe në përputhje me numrin faktik të studentëve të regjistruar, Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Ligji për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr.9887 dt.10.03.2008 ndryshuar me ligjin Nr.48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të</p>	<p>Personeli akademik propozohet nga departamenti përkatës, në këtë rast Departamenti i Shkencave Sociale dhe miratimi bëhet nga dekani i Fakultetit dhe Rektori i Universitetit të Korçës¹⁰². Zyra e burimeve njerëzore angazhohet në mbledhjen, ruajtjen dhe përditëson si çdo vit akademik, të të dhënave të stafit akademik.¹⁰³ Numri i studentëve të</p>

⁹⁸ Shtojca 1.1. Statuti UK

⁹⁹ Shtojca 1.2. Rregullorja e UK

¹⁰⁰ Shtojca 1.4. Rregullorja e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit.


¹⁰¹ Shtojca 2.9. Jetëshkrimet e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit.

¹⁰² Shtojca 1.13. Udhëzim Rektorati për rekrutimin e stafit.

¹⁰³ Shtojca 1.14. Udhëzim për përmbajtjen e dosjes së stafit UK

<p>përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësmësimitor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>rregjistruar në programin e studimit me karakter profesional “Shërbim Social” për vitin akademik 2021 – 2022, është gjithsej 40. Gjithashtu praktikat mësimore ndiqen nga një pedagog i departamentit dhe në institucionin pritës ku do të kryej praktikën profesionale, studenti monitorohet nga një tutor i cili ndjek studentin në terren. Praktikrat profesionale kanë një impakt pozitiv në vijimësinë e këtij programi profesional, kjo bazuar edhe në takimin me studentët e këtij programi profesional por edhe bazuar në veprimtaritë e pasqyruara nga institucioni në dokumentacionin e shqyrtuar nga GVJ.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Detyrat e stafit akademik dhe ndihmës janë të përcaktuara në rregulloren e institucionit, Fakultetit dhe Departamentit të Shkencave Sociale si njësi bazë që përgjigjet direkt për përmbushjen e objektivave të programit të studimit me karakter profesional. Ngarkesa mësimore dhe shpërndarja e saj dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij programi profesional të studimit. Infrastruktura në UK-ës ka krijuar kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Institucioni disponon salla leksionesh dhe auditore për seminare, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme mësimore. Për programin e studimit me karakter profesional “Shërbim Social” ka në dispozicion mjedise fizike me infrastrukturën e nevojshme me auditore, laboratore dhe bibliotekë, për mbarrëvajtjen e procesit mësimor për stafin dhe studentët. Institucioni ofron gjithashtu ambiente shlodhëse të cilat janë në dispozicion të stafit dhe studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të</p>	<p>Institucioni bën përpjekje për kualifikimin dhe zhvillimin profesional të personelit të Programit profesional “Shërbim Social” nëpërmjet organizimit të leksioneve të hapura, konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe trajnimeve për përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies sipas dokumentit. Këto aktivitete pasqyrohen gjithashtu edhe në web-faqen e institucionit. Institucioni ka fituar 4 projekte mobiliteti për 2021 dhe ka aktive dhe 6 projekte të tjera të cilat u shtynë për shkak të kushteve të pandemisë globale¹⁰⁴. Gjithashtu stafi akademik i institucionit kishte mundësi të merrte pjesë në konferencat e organizuara nga UK pa pagesë. Thirrjet për stafin shpallen në faqen</p>

¹⁰⁴ Shtojca 2.19. Mobilitete staf student ERASMUS+

personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	zyrtare të institucionit, ndërsa për studentëve përveç rrjeteve sociale janë planifikuar edhe ditët e hapura për studentët si dhe përgatitja e gjithë dokumentacionit për mobilitet nga ana e zyrës së projekteve pa pagesë për të gjithë studentët e interesuar ¹⁰⁵ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Universiteti “Fan S. Noli” Korçë si një institucion me numër në rënie të studentëve kohët e fundit e përmbush këtë kriter nga pikëpamja e sipërfaqes dhe mjediseve të nevojshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Mjediset e godinave plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral, hapësirat dhe facilitetet. Mësimi në Programin e studimit me karakter profesional në “Shërbim Social” ka në dispozicion salla leksioni, seminari, zyra, biblioteka dhe salla laboratorit të cilat kanë infrastrukturën e duhur për një proces normal të nxënies.
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e	Mjediset mësimore në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, të tilla si tabela whiteboard dhe wireless, të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimin në kushte bashkëkohore ¹⁰⁶ . Laboratori i cili është në funksion të zbatimit të këtij program studimi, është i kompletuar me pajisje kompjuterike (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet) dhe është i aksesueshëm për të gjithë

¹⁰⁵ Dokumentacioni i “Momentet e Takimit gjatë Vizitës në Institucion”

¹⁰⁶ Shtojca 1.15. Raporti i kontrollit të kapaciteteve të MASR


<p>teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>studentët. Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me videoprojektor, laptop, whiteboard, platform online dhe të gjitha mjetet e tjera logjistike¹⁰⁷.</p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Mjediset mësimore në UK-ës janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, të tilla si tabela whiteboard dhe wireless, të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimin në kushte bashkëkohore. Laboratori i teknologjisë së informacionit që është në funksion të zbatimit të këtij program studimi, është i kompletuar me pajisje kompjuterike (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet) dhe është i aksesueshëm për të gjithë studentët¹⁰⁸.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Ky program studimi profesional zhvillohet në ambjentet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Humane në një godinë 3 katëshe, me sipërfaqje prej 3357m² në të cilin vihen në dispozicion salla leksionesh, seminaresh, laborator të teknologjisë së informacionit. Bazuar në specifikat e profilit profesional “Shërbim Social” mjediset në dispozicion janë të favorshëm për të realizuar qëllimet mësimore të lidhura me përvetësimin e dijeve dhe kompetencave profesionale të studentëve. Ky fakultet në funksion të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor ka disa laboratore bashkohore dhe me infraskulturën përkatëse për realizimin e objektivave të programit të studimit¹⁰⁹.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Humane ndodhet në një godinë të rikonstruktuar të pajisur me të gjitha infrastrukturën e nevojshme. Në këtë godinë janë në dispozicion 9 salla leksionesh dhe seminaresh me videoprojektor si dhe 6 laboratore kimie, biologjie, fizike dhe të teknologjisë së informacionit. Godina ka një sitem ngrohje qëndror e cila lejon zhvillimin e mësimin në kushte optimale, godina ka hapsira të bollshme brenda dhe me mjediset jashtë çlodhësedhe me gjelbërim¹¹⁰. Kjo godinë është e pajisur edhe me një bibliotekë me hapsira të bollshme të dedikuara për stafin dhe studentët.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

¹⁰⁷ Shtojca 1.15. Raporti i kontrollit të kapaciteteve të MASR

¹⁰⁸ Shtojca 1.15. Raporti i kontrollit të kapaciteteve të MASR

¹⁰⁹ Shtojca 1.15. Raporti i kontrollit të kapaciteteve të MASR

¹¹⁰ Shtojca 1.15. Raporti I kontrollit të kapaciteteve të MASR

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijojnë kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka ka hapësira dhe u jep mundësi studentëve të bëjnë kërkime online apo të studiojnë materiale fizike në një mjedis me hapësira dhe kushte komode për studim. Ajo është e pajisur me tavolina studimin, kompjuter dhe internet pa limit përmes sistemit wi-fi për të gjithë studentët dhe anëtarët e personelit që duan të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës për shfletim të literaturës për nevoja të ndryshme. Universiteti “Fan S. Noli” Korçë disponon një Bibliotekë e cila ka një fond librash prej 10592 titujsh, 9048 tituj ofrohen në gjuhën shqipe ndërsa 1544 tituj në gjuhë të huaj, duke përfshirë edhe tituj të fushave të ndryshme, ndër të cilat ka dhe tituj të fushës së shkencave sociale si psikologjisë, sociologjisë dhe filozofisë ¹¹¹ . Gjithashtu edhe Biblioteka e Qendrës së Ekspelences ofron një fond të specializuar librash në fushën didaktiko-shkencore dhe me një fond prej 190 tituj në shqip dhe 490 tituj në gjuhë të huaj. Krahas literaturës fizike, institucioni përdor materiale ndihmëse dhe informuese për studentët si dhe forma e leksioneve në Pdf të cilat i vihen në dispozicion studenteve nëpërmjet faqes online. Çdo student ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë dhe të aksesit të bibliotekës online U-Library .
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Kapaciteti që ka biblioteka garanton deri diku mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët e programit të studimit me karakter profesional. Gjatë vizitës në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë na u sqarua se punonjësja e bibliotekës kapacitetet e mjaftueshme për akomodimin e studentëve sipas orareve të funksionimit për të gjitha programet e studimit. Për fushën e “Shërbimit Social” janë më shumë libra në versionin online sesa në atë të printuar. <i>Sugjerohet nga GVJ që njësia të shtojë përpjekjet për pasjen në dispozicion të më shumë librave të printuar në fushën e “Shërbimit Social” në gjuhën shqipe.</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të	Shërbimet e bibliotekës ofrohen pa pagesë për të gjithë studentët e Universitetit “Fan S. Noli” Korçë dhe për personelin e institucionit. Për t’u bërë anëtar i bibliotekës mjafton një regjistrin i thjeshtë me një kartë identiteti dhe një fotografi dhe studenti hap librezën e bibliotekës. Përmes saj studentët dhe stafi kanë të drejtë të tërheqin libra nga

¹¹¹ Shtojca 2.23 Fondi i bibliotekës.

<p>detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>biblioteka për afate të përcaktuara. Biblioteka on-line U-Library dhe ofrojnë gjithashtu akses shfrytëzimi të barabartë për të gjithë studentët si fizikisht ashtu dhe në biblioteka on-line. Studentët e këtij program studimi kanë në dispozicion të tyre bibliotekën online të cilën mund ta shfrytëzojnë sipas interesave të tyre kërkimore.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojnë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>Universitetit “Fan S. Noli” Korçë për të garantuar vazhdimësinë e tij në të ardhmen dhe sigurinë e programit mësimor ka lidhur një sërë marrëveshesh institucionale¹¹² dhe përdor mjete të favorshme kompjuterike për realizimin teorik të këtij programi. Në funksion të nevojës për zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve në drejtim të përvetësimit të njohurive praktike një sërë veprimtarish ndërmerren nga institucioni, si lehtësimi i përvojës praktike nga puna vulnetare në institucionet pritëse¹¹³, monitorimi i tyre nga një supervisor në institucion, aktivitetet ekstra kurrikulare, lektorë të ftuar¹¹⁴ etj. Një rëndësi e madhe i jepet përfshirjes së studentëve në veprimtari praktike, përgjatë 2 viteve akademike me një shpërndarje në të dy semestrat, si në semestrin e 2 të vitit të parë ashtu edhe në semestrin e 1 të vitit të dytë akademik. Familjarizimi i hershëm me institucionet ku kryhet praktika profesionale ndihmon studentët e këtij program profesionale të zhvillojnë kompetenca profesionale dhe njohuri specifike për profilin profesional.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>Rregullat për shpërndarjen e burimeve dhe të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij janë në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”¹¹⁵, përcaktohen nga Bordi i Administrimit¹¹⁶, i cili është organi që mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit, duke garantuar qëndrueshmërinë financiare të UK-ës dhe përmbushjen e misionit të tij, përmes miratimit të propozimeve që vijnë nga senati akademik sipas rregullave në fuqi.</p>
<p>Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë</p>	<p>Financimi i programit të studimit profesional “Shërbim Social” siguron e garanton mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e</p>

¹¹² Shtojca 2.13 Tabela përmbledhëse program i praktikës profesionale

¹¹³ Shtojca 2.14. Punë studentore

¹¹⁴ Shtojca 3.18 Shëmbuj nga orët e hapura të organizuara nga DSHS

¹¹⁵ Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 08-10-2021).

¹¹⁶ Shtojca 1.21. Rregullore e bordit të administrimit.

mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.	që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare në vijimësi ¹¹⁷ . Bazuar në planin e zhvillimit të strategjik të UK-ës, hapja e programeve të reja në vitet e fundit vjen si një domosdoshmëri për të nxitur rritjen e numrit të studentëve në ato fakultete që u rrezikuan nga vendosja e notës mesatare sipas udhëzimeve të MASR.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni i Arsimit të Lartë UK-ës bazohen në aktet ligjore në fuqi¹¹⁸ për politikën që lidhen me kriteret e pranimit, të ndërprerjes dhe transferimit të studentëve në këtë program studimi me karakter profesional. Elementët përbërës të këtij program studimi janë konform ligjit për arsimin e lartë dhe VKM nr 41, duke respektuar të drejtat e çdo kandidati për tu rregjistruar dhe duke lehtësuar procedurat për të favorizuar kategoritë në nevojë, duke caktuar kuota të veçanta për to. Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Gjithashtu informacion mbi organigramën e Fakultetit, dhe strukturën e programit të studimit afishohet në stendat e institucionit si edhe një informacion më pak i detajuar shfaqen në faqen e internetit të UK-ës si dhe në faqen zyrtare e në rrjetet sociale.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithshme</p>	<p>Mësohet se institucioni mbështetet në rregulloren e tij, procedurën e regjistrimit dhe kriteret e kërkuara, të rregulluar në përputhje me ligjet në vend nga hyrja në dalje. Kandidati duke ndjekur një procedurë të caktuar dhe në afatet</p>

¹¹⁷ Shtojca 1.3.1. Draft plani strategjik I zhvillimit të UNIKO

¹¹⁸ Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri"

dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.	ligjore të përcaktuara me ligj mund të kryej rregjistrimit, ndërprerjen, transferimin e studimeve në përputhje me të drejta të plota për të gjithë. Të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendëshme e këtij programi studimi. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese dhe është pjesë e fushatave informuese përmes fletëpalosjeve ¹¹⁹ .
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.	Institucioni angazhohet përmes një sërë formash në promovimin dhe reklamimin e programeve të studimit në kushtet e pandemisë kryesisht duke përdorur faqen zyrtare të webit ¹²⁰ dhe faqen zyrtare në facebook ¹²¹ . UK-ës dhe njësia bazë vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore, por edhe takimet informuese që realizohen ditët e para të fillimit të vitit akademik, lehtësojnë njohjen e studentit me këto procedura.
Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësisë, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencial, nëpërmjet fletëpalosjeve, komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Informacioni mbi programin e studimit përfshin edhe hapësirat për punësim pas diplomimit i cili u jepet studenteve. Gjithashtu edhe gjatë takimit me studentët, ata shprehën se kanë marrë informacion në universitet nga pedagogët e lëndëve të ndryshme të programit të studimit dhe njësia bazë mbi profilin e punës që mund të kryejnë pas diplomimit.
Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor,	Sistemi online siguron akses në një numër informacioni si regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, akses i plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin por jo në materialet e lëndëve që nuk i përkasin. Secili pedagog është regjistruar në sistem në lëndët e veta; Çdo pedagog mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse. Institucioni siguron informacion të arritshëm edhe në distancë për studentët me anë të faqes zyrtare të ëëbit, komunikimi në vijimësi në

¹¹⁹ Shtojca 3.11. Praktika e informimit të studentëve me programin e studimit.

¹²⁰ Universiteti Fan S. Noli, Korçë.


<https://www.google.com/search?q=universiteti+i+korces&oq=&aqs=chrome.0.35i39i362l4j46i39i362j35i39i36213...8.14196497710j0j15&sourceid=chrome&ie=UTF-8>(aksesuar më 12.11.2021).

¹²¹ <https://www.facebook.com/unkorce/> (aksesuar më 12.11.2021).

<p>logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>nivel departamenti, njoftimi përmes platformës Teams dhe adresave të email si dhe njoftimeve në rrjetet sociale. Përmes platformës on-line, institucioni ofron mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forume diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Ky sistem ka rezultuar i dobishëm vecanërisht përgjatë këtij viti akademik si pasojë e pandemisë Covid 19. Në dispozicion të studentëve të programeve të studimit aksesit tek informacioni mbi kurrikulën dhe programin e studimit mund të merret në faqen zyrtare të institucionit, ose gjatë fazës së regjistrimit. Gjithashtu duke përdorur platformën digjitale ESSE studentët mund të marrin informacion për lëndët që do të zhvillojnë përgjatë semestrit dhe vitit akademik. Silabuset e lëndëve mësimore përmbajnë informacione të detajuara mbi ngarkesën, temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar. Orari mësimor, plani mësimor afishohen në ambjentet e Fakultetit dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e UK-së lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj.</p>
<p>Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>UK-ës ka një sistem të menaxhimit të brendshëm¹²² që e aplikon në lidhje me ruajtjen dhe përpunimin e informacionit për nevoja të brendshme dhe të jashtme. Sistemi¹²³ ofron mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forume diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimi të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti. Sistemi përgjatë kohës së pandemisë ka dëshmuar më së miri efikasitetin e tij në realizimin konform rregulloreve të një sër veprimtairish didaktiko-pedagogjike të domosdoshme për vijimësinë e procesit mësimorë dhe ndërveprimin midis stafit akademik dhe studentëve. Sistemi ESSE ofron mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh.</p>

¹²² Shtojca 1.6. Rregullore e ESSE

¹²³ Shtojca 1.6.1 Marrëveshja RASH për Esse

	caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit. Çdo informacion aksesohet nga cilido i interesuar në kohë reale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5



Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.	Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës. Ky informacion administrohet dhe ruhet në hard -copy. Sistemi i menaxhimit të informacionit të UK-ës është ESSE, i cili është në funksion të ruajtjes, administrimit dhe përpunimit të të dhënave të studentëve për të gjitha programet e studimit, të stafit akademik, ndihmës akademik dhe atij administrative të institucionit. Kjo strukturë është përgjegjëse për raportet financiare të institucionit, statistikën përshkuese të buxhetit, zërat për menaxhimin e aspekteve të funksionimit të universitetit, financat e studentëve që përbëjnë dhe burimin kryesor të të ardhurave. Ky sistem elektronik ¹²⁴ shërben për administrimin e informacionit personal të studentëve dhe evidence mbi rezultatet e provimeve ndër vite. Ky sistem administrohet nga personat e zyrës së IT-së me detyrë funksionale menaxhimin teknik të sistemit ESSE. Institucioni ka zyra mbështetëse të cilat mundësojnë administrimin dhe shpërndarjen e informacionit duke respektuar të drejtën e ruajtjes së të dhënave personale ¹²⁵ .
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit	Informacioni, dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrative dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit menaxhohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Institucioni ka në dispozicion një sistem të brendshëm të menaxhimit që quhet ESSE. Ky sistem elektronik

¹²⁴ Shtojca 1.6.1 Marrëveshja RASH për esse

¹²⁵ Shtojca 1.9. Rregulloret e ruajtjes së të dhënave.

<p>administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>administron materialet e hedhura nga stafi akademik për lëndët dhe modulet e ndryshme, material shtesë, pikë dhe vlerësimet e studentëve në lëndë të ndryshme. Ai informon studentët për pikët dhe notat on-line në kohë reale. Gjithashtu, ky sistem lejon ruajtjen e dokumentacionit dhe aktivitetet e personelit akademik. Ky sistem është në funksion kryesisht të procesit të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Universitetit “Fan S. Noli” Korçë siguron në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Platforma elektronike lehtëson komunikim interaktiv dhe mundëson shkëmbimin e informacionit midis pedagogëve dhe studentëve në kohë reale. Sistemi i menaxhimit të informacionit të UK-së është një program, i cili është i aksesueshëm nga persona të autorizuar dhe gjithashtu mund të krijohen kushte për akses në informacione e dokumenta për studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në kushtet e pandemisë përdorimi i platformës on-line ka qenë domosdoshmëri. Të gjitha aktivitetet akademike janë realizuar përmes sistemit Microsoft Teams, apo platformave të tjera si Google classroom, Zoom etj. Në funksion të kushteve ku mësimi realizohet on-line ka pasur edhe modifikime të sistemit të vlerësimit të veprimtarive didaktiko-praktike të cilat ishin të pamundura të realizohen në auditor. Sistemi ESSE dhe Teams siguron akses në një numër informacioni si regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, akses i plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin. Secili pedagog është regjistruar në sistem në lëndët e veta; Çdo pedagog mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse; Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkesë që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forum diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimet të përgjithshme në rang Fakulteti</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson</p>	<p>Bazuar edhe në numrin e stafit akademik dhe programeve të studimit në UK-ës, sistemi i menaxhimit siguron monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale</p>

raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	me ta. Ky sistem menaxhimi garanton monitorimin në kohë reale të një sër aktivitetesh që lidhen me mbarëvajtjen e procesit akademik përmes statistikave numerike të gjeneruara prej tij. Në fund të çdo semestri gjenerohen statistika përshkruese në lidhje me aktivitetet akademike të ndërmarra nga stafi akademik. Këto të dhëna i vihen në dispozicion përgjegjësit të departamentit, organeve drejtuese dhe personave të tjerë përgjegjës për monitorimin e ecurisë së procesit mësimor.
--	--

Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja e webit aktualisht ishte në rikonstruksion dhe rrjetet sociale ishin më tepër aktive në këtë drejtim. Nga informacioni i marrë gjatë vizitës në institucioni, UK publikon në shqip dhe anglisht, në faqen e tij të internetit informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitete të ndryshme. Në faqen zyrtare të UK-së https://moodle.unkorce.rash.al/ paraqitet një informacion i plotë mbi filozofinë dhe misionin, partnerët, drejtimin dhe funksionimin, organikogramën; guidat për studentët e ardhshëm të Universitetit si dhe mbi programet, së bashku me bio të detajuara të personelit akademik etj. Përmes saj, por edhe rrjeteve sociale, UK promovon veprimtaritë e ndryshme me karakter akademik dhe ekstrakurrikulare. Kjo faqe bën publikimin në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.
---	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe

<p>zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeseshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR¹²⁶ si dhe statutin dhe rregulloren e brendëshme e këtij programi studimi. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese dhe është pjesë e fushatave informuese në shkolla përmes fletëpalosjeve¹²⁷.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e njësisë bazë të institucionit¹²⁸ dhe të asaj të programit të studimit¹²⁹, mbi procedurën në hyrje e në dalje¹³⁰, si dhe orientimin drejt tregut të punës është rregulluar në përputhje me ligjet në vend nga hyrja në dalje. Kandidati duke ndjekur një procedurë të përcaktuara me ligj mund të kryej ndërprerjen, transferimin e studimeve në përputhje me të drejta të plota për të gjithë. Institucioni informon si studentët potencialë edhe ata që regjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi nëpërmjet “Zyrës së Karrierës”¹³¹. Duke qenë program studimi me karakter profesional pas përfundimit të shkollës së mesme nuk ka kufizimi që pengojnë regjistrimin e studentëve (kriter i vetëm është shkolla e mesme), garantohet barazia dhe të drejta e njëjta për të gjithë kandidatët për studentë që të bëhen pjesë e tij. Madje në këtë drejtim mund të themi se Institucionet publike janë favorizuese me procedurat dhe politikat e tyre edhe për kategoritë në nevojë, duke mbështetur studentët potencial nga këto shtresa me reduktim tarifash apo bursa studimi.</p>

¹²⁶ Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 08-10-2021).

¹²⁶ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 08-10-2021).

¹²⁷ Shtojca 3.11. Praktika e informimit të studentëve me programin e studimit.

¹²⁸ Shtojca 2.3. Rregullorja e Njësisë Bazë.

¹²⁹ Shtojca 2.5. Rregullorja e Programit të studimit 2021-2022

¹³⁰ Shtojca 3.9. Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit

¹³¹ Shtojca 1.4. Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit

<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni angazhohet përmes një sërë formash në promovimin¹³² dhe reklamimin e programeve të studimit. Përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni realizon një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi, për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre në UK¹³³. Format, me të cilat realizohen udhëzimi i studentëve, në lidhje me kriteret e përgjithshme/të veçanta, për t'u regjistruar në programin profesional me karakter profesional "Shërbim Social" pas mbarimit të shkollës së mesme janë të hapura për të gjithë të interesuarit dhe kriteri për të vazhduar studimet në këtë program profesional dy vjeçar¹³⁴ janë të lidhura me zotërimin e një diplome të shkollës së mesme, dhe të njohë gjuhën shqipe, edhe pse kriteri i fundit nuk është shprehur specifikisht në programin e "Shërbim Social".</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore, por edhe takimet informuese që realizohen ditët e para të fillimit të vitit akademik, lehtësojnë njohjen e studentit me këto procedura. Studentët njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformave online ESSE ose Teams. Studentët e interesuar mund të tërheqin pranë sekretarisë mësimore vërtetimin e notave, në të cilën gjenden të gjithë lëndët dhe rezultatet respektive, sikurse dhe statusi për çdo lëndë. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuar në rregulloret e njësisë kryesore dhe asaj bazë, si edhe në programet e cdo lënde. Meqënëse programi u bëhet i ditur studentëve që orën e parë të mësimit, ata njihen edhe me mënyrën e vlerësimit të tyre në cdo lëndë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Për të gjithë studentët e rinj të regjistruar realizohet "Java e Orientimit", e cila është e përvitshme në universitet. Gjatë kësaj jave realizohen takime, leksione të hapura për shpjegimin e sistemit të studimeve, rregulloreve dhe procedurave administrative të UK-ës. Në çdo lëndë apo modul janë përcaktuar qartë të gjitha informacionet që lidhen me procedurat që ndjek institucioni për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentit. Këto procedura janë të unifikuara për të gjithë universitetin, dhe janë të bazuara në udhëzimet e MASR</p>

¹³² Shtojca 3.10. Praktika e promovimit dhe informimit të maturantëve

¹³³ Shtojca 3.11. Praktika e informimit të studentëve me programin

¹³⁴ Shtojca 3.9. Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit

	<p>për strukturën e hartimit të silabusit të lëndës. Njësia bazë përmes strukturave të saj informon studentët në lidhje me mundësitë e diplomimit përmes dy formave; Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP) ose temës së diplomës. Për të mbrojtur diplomën me temë kërkohet mesatarja mbi 8.5 dhe mbetet opsionale sipas dëshirës së studentit për ta përzgjedhur ose jo këtë formë diplomimi. Departamenti vë në dispozicion të studentëve një listë me pedagogë dhe ata janë të lirë të zgjedhin udhëheqësin e tyre. Institucioni përcakton rregulla për monitorimin e progresit në punimin e diplomës përmes ndjekjes me detyrim të seancave metodologjike me udhëheqësin. Për provimin e përgjithshëm përfundimtar jepet një udhëzim në lidhje me tematikat e përfshira. Fazat kohore të mbrojtjes së diplomës përmes provimit me shkrim bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. Monitorimin e këtyre procedurave që lidhen me provimin e përgjithshëm përfundimtarë e realizon koordinatori dhe drejtuesi i njësive bazë</p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik institucioni organizon takime të hapura me të interesuarit për ti informuar mbi programet e studimit që ofron. Këto takime të hapura zhvillohen edhe në shkolla të mesme por edhe duke i fuar maturanët në ambientet e UK-ës. Gjithashtu institucioni përgatit udhëzime, fletëpalosje dhe postera për të bërë publike programet e studimit të ofruara prej tij, përmes rrjeteve sociale. Institucioni ndjek politika që synojnë reklamimin dhe promovimin e tij në vazhdimësi, përmes rrjeteve sociale dhe fletëpalosjeve. Në lidhje me tërheqjen e studentëve të rinj çdo pranverë UK-ës organizon grupe pune të përbëra nga pedagogë dhe studentë, të cilët vizitojnë shkolla të mesme për t'u bërë të njohur maturanëve programet e studimit që ofron, kushtet dhe shërbimet për studentët, për t'i ndihmuar ata në vendimarrje¹³⁵, përjashto 2 vitet e fundit të kushtëzuara nga kushtet e pandemisë globale. Veprimtaritë "Universiteti me dyer të hapura" janë veprimtari që i ftojnë maturanët në vizitë në institucionin dhe të ndjekin orë leksioni të hapura si dhe "Java e Orientimit" për studentët e vitit të parë para fillimit të vitit akademik ndihmojnë studentët të marrin informacionin e nevojshëm. Përgjatë javëve të regjistrimit, UK vë në dispozicion të maturanëve të interesuar për të vazhduar studimet e larta, pedagogë sipas fakulteteve¹³⁶. Ata japin të</p>

¹³⁵ Shtojca 3.10. Praktika e promovimit dhe informimit të maturanëve

¹³⁶ Shtojca 3.11. Praktika e informimit të studentëve me programin

	gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen, rregulloren, mundësitë e punësimit dhe mundësitë e transferimit të studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencial, nëpërmjet fletëpalosjeve, komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Në dispozicion të studentëve të programeve të studimit aksesit tek informacioni mbi kurrikulën dhe programin e studimit mund të merret në faqen zyrtare të institucionit, ose gjatë fazës së regjistrimit ¹³⁷ . Gjithashtu duke përdorur platformën digjitale studentët mund të marrin informacion për lëndët që do të zhvillojnë përgjatë semestrit dhe vitit akademik. Silabuset e lëndëve mësimore ¹³⁸ përmbajnë informacione të detajuara mbi ngarkesën, temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar. Pedagogët gjithashtu e japin këtë informacion në fillim të çdo semestri për secilën prej lëndës apo modulit që japin.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikën profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e	Institucioni ka në dispozicion të orientimit profesional të studentëve zyrën e Këshillimit të Karrierës e cila zhvillon aktivitetin e saj duke bashkëpunuar ngushtë me njësinë bazë së çdo fakultet. Gjithashtu marrëveshjet e bashkëpunimit institucional ¹³⁹ që Universiteti “Fan S. Noli” Korçë ka nënshkruar për qëllime të zhvillimit të praktikës, shkëmbimit të eksperiencave dhe për realizimin e veprimtarive kërkimore shkencore ¹⁴⁰ janë faktor kyç për zhvillimin e kompetencave

¹³⁷ Shtojca 2.7. Plani Mësimor i Programit të Studimit

¹³⁸ Shtojca 2.8. Programet Lëndore të Programit të Studimit 2020-2021.

¹³⁹ Shtojca 2.10. Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale

¹⁴⁰ Shtojca 2.19. Mobilitete staf student ERASMUS+

<p>mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>didaktiko-praktike dhe të edukimit në vazhdim. Institucione si “Qendra Rezidenciale Korçë”, “Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor”, “Drejtoria e Shëndetit Publik”, “Bashkia Korçë” dhe “Bashkia Maliq”, “Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror”, “World Vision Korçë”, “Qendra për Zhvillimin e Fëmijëve” (KIDC) etj krijojnë mundësi shumë të mirë jo vetëm në drejtim të realizimit të praktikave profesionale por edhe në krijimin e hapsirave për të realizuar eksperiencën pune vulnetare shërbejnë si urë lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës, jo vetëm në kuadrin e praktikave profesionale por edhe për të ndërmjetësuar në punësimin e studentëve sipas nevojave të institucioneve publike dhe private. Organizimi i panairëve të punës dhe aktiviteteve të tilla si leksione të hapura me aktorë nga tregu i punës, ekperiencat në institucione të tjera si pjesë e realizimit të praktikës profesionale janë veprimtari që synojnë të qartësojnë studentët dhe të orientojnë rreth mundësive për punësimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor si orari mësimor etj në faqen zyrtare në rrjetet sociale. Plani mësimor afishohet në ambjentet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Humane dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e UK-ës lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si sallat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj. Në funksion të nevojave të studentëve janë edhe vetë pedagogët e moduleve/lëndëve, kordinatori i programit të studimit por edhe zyra e këshillimit të karrierës.</p>
<p>Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Platforma ESSE, Teams etj ofrojnë mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forume diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Këto sisteme kanë rezultuar të dobishëm vecanërisht përgjatë viteve akademike 2019-2020 dhe 2020-2021 si pasojë e pandemisë Covid 19, ku aksesimi ka qenë gati 100% nga studentët, sic shprehen drejtuesit e njësi bazë dhe pedagogët gjatë takimit. Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimet të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti. Çdo informacion aksesohet nga cilido i interesuar në kohë reale.</p>

	Gjatë intervistës me stafin akademik por edhe grupin e punës na u referua se cdo pedagog ofron komunikimin me e-mail me studentët, të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në laboratorin e teknologjisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.	Bazuar në statistikat e institucionit ¹⁴¹ mbi numrin e studentëve të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit, rezulton se ky program studimi ka nxjerr dy breza të diplomuar studentësh. Përgjatë dy viteve akademike 2019-2020 dhe 2020-2021 janë diplomuar në total nga 61 studentë. Bazuar në të dhënat mbi mënyrën e përmbjlljes së detyrimeve akademike rezulton se 20 studentë kanë zgjedhur të diplomohen përmes një teme diplome të realizuar nën udhëheqjen e stafit akademik, ndërsa pjesa tjetër përmes provimit të formimit.
Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaria mësimore, nëpërmjet rregjistrave përkatës mban informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë, të transferuar dhe të larguar nga programi i studimit për cdo vit akademik. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga UK përmes ASCAL ¹⁴² , rezulton se për vitin akademik 2019-2020 janë regjistruar gjithsej 40 studentë, sipas të dhënave statistikore nuk rezulton të ketë student të transferuar apo që kanë ndërprerë studimet. E njëjta situatë paraqitet edhe për vitin akademik 2020-2021, me 40 studentë të regjistruar dhe asnjë transferim. Edhe për vitin akademik 2021-2022 kemi 40 studentë të regjistruar në këtë program studimi me karakter profesional.

¹⁴¹ Shtojca 4 Tabela përmbledhëse për programin e studimit

¹⁴² Shtojca 4 Tabela përmbledhëse për programin e studimit



<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.</p>	<p>Sekretaria mësimore rregjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi i tyre deri në diplomimin e tyre. Statistikat¹⁴³ për ecurinë e studentëve janë të pasqyruara përgjatë të dy viteve dhe fokusohen në të dhëna mbi numrin e studentëve sipas viteve të studimit, nota mesatare e hyrjes është 6.2 për vitin akademik 2019-2020 dhe 6.3 për vitin akademik 2020-2021, nuk rezulton të ketë studentë të transferuar apo që kanë ndërprerë studimet në këtë program studimi me karakter profesional. Referuar burimit të të dhënave për periudhën 2020-2021, përsa i përket studentëve të diplomuar (N=61), rezulton se të punësuar në përputhje me diplomën kemi në total 10 studentë. Ndërsa rreth 30 studentë janë të punësuar në sektor të tjerë jo në përputhje me diplomën e fituar.</p> <p><i>GVJ bazuar edhe në shqetësimin e sjell nga studentët e pranishëm në takim gjatë vizitës në institucion, sugjeron njësinë kryesore dhe bazë të llobojnë në mënyrë aktive në institucionet publike dhe private në rrethin e Korçës, me qëllim rritjen e vizibilitetit të diplomës dhe si rrjedhojë edhe të rritjes së numrit të të punësuarve në linjë me kualifikimin e kryer.</i></p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Detyrat e sekretarisë janë të përcaktuara në rregullore e sekretarisë mësimore¹⁴⁴. Zyra e regjistrimit të studentëve që realizohet përmes sekretarisë mësimore është struktura e posaçme që merret me ruajtje¹⁴⁵ dhe menaxhimin e të dhënave statistikore nga hyrja deri në dalje. Punën e tyre në drejtim të menaxhimit të rekordeve të studentëve e realizojnë edhe përmes sistemit informatik elektronik ESSE¹⁴⁶. Këto të dhëna disponohen për të gjithë studentët e UK Studenti ka dosjen personale, e cila ka të gjitha të dhënat që janë marrë në fazën e regjistrimit si deklarata e studentit, dokumenti i identifikimit, Deftesë dhe listë notash e noterizuar e shkollës së mesme, kontrata e studentit. Këto të dhëna vazhdojnë të përditësohen në vijim përgjatë viteve të studimit. Personat e autorizuar mbështeten në sistemin e brendshëm të informacionit dhe rregjistrat për të</p>

¹⁴³ Shtojca 4 Tabela përmëdhëse për programin e studimit

¹⁴⁴ Shtojca 1.10. Rregullore e sekretarisë mësimore.

¹⁴⁵ Shtojca 1.9. Rregullore e ruajtjes së të dhënave.

¹⁴⁶ Shtojca 1.6. Rregullore e ESSE

	gjeneruar statistika mbi studentët në mënyrë të saktë.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Njësia kryesore në bashkëpunim me njësinë bazë bëjnë një analizë vjetore të veprimtarisë bazë në të cilën paraqiten edhe gjetjet dhe rekomandime përkatëse ¹⁴⁷ . Referuar raporti të departamentit mbi punën e tij për vitin akademik 2020-2021 ka një qëndrim pozitiv mbi ecurinë e këtij programi profesional studimi ku numri i studentëve në vitin e parë të hapjes dhe në vijim ka qenë konstant. Ndërsa lidhur me shkallën e punësimit të studentëve të këtij programi studimi profesional janë të ulta. Bazuar në rekomandimet e analizës së njësisë bazë ndër prioritet e saj përmendet edhe nevoja për një angazhim më të madh në drejtim të punësimit të studentëve të profilit “Shërbim social”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Nëpërmjet Statutit të UK-ës ¹⁴⁸ , rregullores së njësisë kryesore ¹⁴⁹ dhe rregullores së njësisë bazë ¹⁵⁰ , institucioni parashikon angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-it. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse si këshillin e studentëve ¹⁵¹ , i cili është grupim i studentëve dhe përzgjedh përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UK-së. Përfshirja e studentëve në një sërë strukturash vendimmarrëse si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ¹⁵² është përcaktuar në aktet ligjore dhe rregulloren dhe statutin e vetë IAL-it.

¹⁴⁷ Shtojca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë

¹⁴⁸ Shtojca 1.1 Statuti i UK.

¹⁴⁹ Shtojca 2.2. Rregullorja e njësisë kryesore

¹⁵⁰ Shtojca 2.3. Rregullorja e Njësisë Bazë

¹⁵¹ Shtojca 1.17. Rregullore e këshillit studentor

¹⁵² Shtojca 1.5. Rregullore e drejtorisë së kurrikulave (NJSBC, QKA)

<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentet e vëna në dispozicion nga UK, GVJ konfirmoi se studentët ishin realisht të përfshirë në këshillim dhe vendimarrje. Studentët kishin përfaqësuesin e tyre si në Senatin e Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, në këshillin e etikës, edhe në zyrën e NJSBC. Sipas Statutit¹⁵³ ata kanë formuar edhe Këshillin studentor. Në të gjitha strukturat ku përcaktohet me ligj përfshirja e tyre, kemi një angazhim të shprehur qartë në lidhje me rolin e studentëve. Ato janë pjesë aktive e mbledhjeve të senatit akademik, punojnë së bashku me stafin në grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, dhe janë në brendësi të punës së tyre në këtë veprimtari. Në lidhje me vlerësimin e stafit akademik studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogut përmes plotësimit të pyetësorit ¹⁵⁴“Për vlerësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies”.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Ngarkesa akademike e studentëve në këtë program studimi është hartuar dhe zbatohet duke respektuar ligjet dhe aktet nënligjore të institucionit dhe në harmoni dhe me udhëzimet dhe vendimet e MASR. Shpërndarja e lëndëve nëpër semestra dhe ngarkesa e shprehur në kredite bëhet mbi parimin e një shpërndarje të balancuar në semestra (afërsisht 30 ECTS për semestër). Ka rregullore dhe procedura që lehtësojnë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme të realizuara më parë ose më pas nga studenti. Grupi i Vlerësimit të jashtëm konstatoi se programet e studimit janë hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve. Statuti i UK-ës dhe rregulloret përkatëse parashikojnë procedura joburokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendimarrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Si një mënyrë e drejtëpërdrejtë në këtë drejtim shërben edhe pyetësi që plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri¹⁵⁵. GVJ konstatoi se pyetjet në pyetësi lidheshin më shumë me performancën e pedagogut se sa me programin e studimit dhe në fakt nuk përbën një burim informacioni në këtë drejtim. Por gjithsesi duke pasur parasysh kohën që ky program studimi profesional është aktiv, do të duhet të presim për të parë vijimësinë e tij dhe mënyrën sesi ky program do të synojë të përmirësojë vetveten në</p>

¹⁵³ Shtojca 1.1 Statuti i UK.

¹⁵⁴ Shtojca 3.13. Pyetësi studentor

¹⁵⁵ Shtojca 3.13. Pyetësi studentor

	përputhje dhe me nevojat e tregut të punës të cilat janë në ndryshim të vazhdueshëm.			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane ¹⁵⁶ , rregullorja e Departamentit të Shkencave Sociale ¹⁵⁷ dhe rregullorja e programit të studimit profesional "Shërbim Social" ¹⁵⁸ mundësojnë barazinë dhe objektivitetin në vlerësimin e procesit të kontrollit të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimimit studentëve si dhe nëpërmjet përcaktimit të procedurës që ndiqen nga institucioni në këtë rast. Studentëve u mundësohet një proces transparent mbi mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, i cili shprehet në rregulloret e brendshme të programit të studimit. Në drejtim të ndershmërisë së kryerjes së procesit janë sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm. Studentët kanë mundësi të parashtrajnë kërkesat e tyre duke drejtuar një kërkesë në njësinë bazë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Universiteti "Fan S. Noli" Korçë ka ngritur "Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit" ¹⁵⁹ . Specialisti i promocionit është ai që ka rolin kryesor në drejtim të këshillimit për karrierën. Bazuar në situatën e konkrete rezulton se specialist në rang institucioni ishte vetëm një person, i cili kryen disa funksione, përfshirë edhe atë të informimit dhe shërbimit ndaj studentëve ¹⁶⁰ Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve

¹⁵⁶ Shtojca 1.2. Rregullorja e UK

¹⁵⁷ Shtojca 2.3. Rregullorja e Njësisë Bazë

¹⁵⁸ Shtojca 2.5. Rregullorja e Programit të studimit 2021-2022

¹⁵⁹ Shtojca 1.4. Rregullore e drejtorisë së burimeve njerëzore, komunikimit dhe promocionit

¹⁶⁰ Shtojca 1.4. Rregullore e drejtorisë së burimeve njerëzore, komunikimit dhe promocionit


	<p>sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Nga vizita në institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u informua se është një zyrë që kryen funksionet e të tre zyrave, për shkak të numrit relativisht të ulët të stafit në këtë drejtori për rolin e specialistit të promocionit.</p> <p><i>Sugjerohet nga GVJ që këto funksione të kryhen nga një zyrë e veçantë në përbërjen e të cilës të jenë staf administrativ i mjaftueshëm që të mbulojë nevojat e tij, për të realizuar pritshmëritë që UK ka për të ardhmen.</i></p>
<p>Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve në organet vendimarrëse, këshilluese dhe të kontrollit të cilësisë së mësimdhënies, studentët kanë mundësi që të asistojnë në çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. Të drejtat e studentëve në këtë drejtim, përveç dokumenteve të sipërpërmendur, përcaktohen edhe në rregulloren e Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit. Në shërbim të studentëve është dhe funksionon kordinatori i programit¹⁶¹, që synon monitorimin e problematikave që lidhen me procesin mësimorë dhe çështje të tjera të cilat ngrihen nga studentët.</p>
<p>Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Promocionit, si pjesë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit¹⁶² është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve dhe përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të tyre për mobilitete në ERASMUS+. Në UK-ës funksionon Alumni, me të cilët bëhen takime të përvitshme për të marrë mendime, ndarë eksperiencë në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës. Gjithashtu organizohen veprimtari të përvitshme të cilat synojnë të ndihmojnë studentët në fazat e ndryshme të vendimarrjes për zgjedhjen e karrierës profesionale në linjë me mundësitë, nevojat dhe aftësitë personale të tyre. Këto aktivitete orientojnë studentët në përzgjedhjen e profilit, dhe më pas në lehtësimin e përzgjedhjes së institucioneve të zhvillimit të praktikës profesionale në linjë me programin e studimit. Seminare të hapura, lektorë të ftuar janë pjesë e</p>

¹⁶¹ Shtojca 2.11. Vendimi I njësisë bazë për emërimin e kordinatorëve të programeve të studimit

¹⁶² Shtojca 1.4. Rregullore e drejtorisë së burimeve njerëzore, komunikimit dhe promocionit

<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>promovimit të profesioneve të ndryshme për studentët e tij.</p> <p>Zyra e Promocionit është një strukturë e ngritur e cila funksionon në bazë të statutit të UK, e cila ka si objektiv të punës së saj mbështetjen e studentëve përgjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik dhe më tej përgjatë viteve të punësimit. Shpesh luan një rol të rëndësishëm në orientimin e studentit drejt mundësive të punësimit, por edhe në drejtim të ofrimit të këshillimit për karrierën me qëllim vlersimin më objektiv të mundësive që student ka në dispozicion. Kjo zyrë me qëllim që të lehtësojë itinerarin e kalimit nga shkolla në punë përpiqet të shfrytëzojë asetet e saj me institucionet locale, kombëtare dhe ndërkombëtare, me të cilat bashkëpunon dhe panairt e punës. Në funksion të lehtësimit të njohjes nga studentët të profilit të tyre dhe tërheqjes drejt një karriere profesionale në programin “Shërbim Social”. Kjo zyrë harton në mënyrë të përvitshme një plan pune i cili përfshin aktivitetet promovuese për njohjen me progrmat e studimit që UK ofron për të gjithë të interesuarit. Funksionimi i kësaj zyre bazohet edhe në rregulloren e saj. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion puna e zyrës së promocionit që mbulon shërbimet e karrierës për studentët vlersohet me një ndikim pozitiv për gjithë institucionin.</p> <p><i>Sugjerimet tona si GVJ lidhen me një mbështetje më të madhe nga ana e institucionit të kësaj zyre me burime njerëzore dhe materiale me qëllim që të përmbush me sukses rolin dhe detyrat.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X





Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “ Shërbim Social” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.

Pikat e forta dhe afirmime

1. Profili profesional i përgjigjet nevojave të tregut për profesionist të kualifikuar të cilët ofrojnë shërbimin e tyre për moshën e tretë dhe kategoritë e tjera me nevoja të veçanta.
2. Qendrat për realizimin e praktikës profesionale janë në përputhje me profilin e programit të studimit profesional “Shërbim Social” duke krijuar mundësi reale në drejtim të zhvillimit të kompetencave profesionale për studentët
3. Dixhtalizimi i sistemit të të dhënave në ndihmë të infrastrukturës në mësimdhënie dhe mësimnxënie.
4. Nxitja e shkëmbimeve në arsimin e lartë për stafin akademik përmes Erasmus +.
5. Përfshirja e stafit akademik në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare të institucionit.
6. Përfshirja e studentit në vlerësimet periodike të formave të mësimdhënies dhe të stafit akademik.
7. Infrastruktura fizike në funksion të realizimit të procesit mësimor.
8. Abonimi në bibliotekën online U- Library

Pika të dobta

1. Mungesa e eksperiencës profesionale mbi rolin e “Shërbimit Social” vështirëson linjën e formimit të profesionistit i cili të qëndrojë brenda profilit profesional të “Shërbimit Social” përgjatë realizimit të praktikës profesionale.
2. Syllabuset e lëndëve mbështeten në një literaturë të vjetëruar dhe jo gjithmonë në linjë me emërtimin e lëndës apo modulit që mbulojnë.
3. Mungesa e lobimit nga ana e institucionit në mënyrë aktive në institucionet publike dhe private në rrethin e Korçës, me qëllim rritjen e vizibilitetit të diplomës.



4. Mungesa e një literature në gjuhën shqipe për studentët e këtij programi studimi me karakter profesional.
5. Mungesa e realizimit të takimeve të hapura me studentët për të komunikuar gjetjet e Raportit të vlersimit të brendshëm të programit të studimit, rezultatet e vlersimit të stafit akademik prej tyre.

Rekomandimet e paraqitura më poshtë nga grupi i vlerësimit të jashtëm mbështeten tek pikat e forta dhe mundësitë e institucionit, për të ndërhyrë dhe përmirësuar pikat e dobëta dhe pengesat në drejtim të konsolidimit dhe zhvillimit në linjë me standartet europiane të programit të studimit profesional "Shërbim Social"

Rekomandime

1. Sugjerohet njësi kryesore dhe bazë të llojshme në mënyrë aktive në institucionet publike dhe private në rrethin e Korçës, me qëllim rritjen e vizibilitetit të diplomës dhe si rrjedhojë edhe të rritjes së numrit të të punësuarve në linjë me kualifikimin e kryer.
2. Përpjekje e shtuar nga njësi bazë për pasjen në dispozicion të më shumë librave të printuar në fushën e "Shërbimit Social" në gjuhën shqipe.
3. Përditësimin e literaturës me botime të 5 viteve të fundit; si dhe kujdes nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, në ruajtjen e një ekuilibri midis emërimit të lëndës mësimore apo modulit dhe literaturës së përdorur për realizimin e saj.
4. Realizimin e dëgjësive publike me praninë e stafit akademik dhe studentve për të diskutuar mbi rezultatet e vlersimit të stafit akademik nga studentët çdo semestër dhe të raportit të vlersimit të brendshëm të programit të studimit, me qëllim nxjerrjen në pah problematikave që kanë nevojë të adresohen.
5. Përzgjedhur në mënyrë më të kujdesshme institucionet e praktikës, me qëllim që tu shërbejnë nevojave të studentëve të këtij profile për t'u përballur me marrësit e vërtetë dhe potencial të shërbimit të tyre.




The evaluation conclusions of the study program with professional character "Social Service" of the Higher Education Institution University "Fan S. Noli"Korçë

Strengths and affirmations:

1. Professional profile responds to the market needs of qualified professionals who provide their service for the elderly and other categories with special needs.
2. Centers for the realization of professional practice are in accordance with the profile of the professional study program "Social Service", creating real opportunities in terms of developing professional competencies for students.
3. Digitalization of the data system to support the infrastructure for teaching and learning.
4. Promoting exchanges in higher education for academic staff through Erasmus +.
5. Involvement of academic staff in national and international projects of the institution.
6. Involvement of students in the periodic evaluations of the forms of teaching and academic staff.
7. Physical infrastructure in function of the realization of the learning process.
8. Subscription to the online library U-Library.

Weaknesses:

1. The lack of professional experience on the role of "Social Service" complicates the line of formation of the professional who stays within the professional profile of "Social Service" during the realization of professional practice.
2. Course syllabus rely on outdated literature and not always in line with the name of the course or module they cover.
3. Lack of lobbying by the institution in an active way in public and private institutions in the district of Korça, in order to increase the visibility of the diploma.
4. Lack of a literature in Albanian language for the students in this study program of professional character.
5. Lack of conducting open meetings with students to communicate the findings of the Internal Evaluation Report of the study program, results of the evaluation of the academic staff by them.



The recommendations presented below by the external evaluation team are based on the strengths and opportunities of the institution and enable intervention to improve weaknesses and threats in terms of consolidation and development in line with European standards of the professional study program of the "Social Service".

Recommendations:

1. It is suggested that the main and basic unit lobbies actively in public and private institutions in the district of Korça, in order to increase the visibility of the diploma and consequently to increase the number of employees in the line with the completed qualification.
2. Increased effort by the basic unit to have more available printed books in the field of "Social Service" in Albanian.
3. Updating the literature with publications of the last 5 years; as well as care by the academic staff engaged in this study program, in maintaining a balance between the name of the course or module and the literature used for its realization.
4. Conducting public hearings with the presence of academic staff and students to discuss the results of the evaluation of the academic staff by students each semester and the internal evaluation report of the study program, in order to highlight the issues that need to be addressed.
5. Carefully selected institutions of practice, in order to serve the needs of students of this profile to face the real and potential recipients of their service.

